



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L-255

PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Mbështetur në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon shërbimet sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike që hartojnë politika dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga institucionet publike dhe private, organizatat joqeveritare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve sociale dhe familjare për të siguruar mirëqenien, kujdesin për dinjitetin dhe jetën e personave në nevojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Shërbimet sociale** - shërbime që ofrohen përmes metodave të punës sociale dhe metodave tjera, me qëllim të rritjes së mirëqenies për individët, familjet e cenuara dhe komunitetin, të cilat ndihmojnë në eliminimin e rreziqeve, e varfërisë, përmirësimin e përfshirjes dhe integritit me qëllim të arritjes së potencialit të plotë në jetë.

1.2. **Përkujdesja e drejtpërdrejtë sociale** - veprimtari e organizuar me interes publik për ofrimin e ndihmës për individët në nevojë sociale, në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin dhe mbikëqyrjen, përkujdesje e cila mund t'i ofrohet në shtëpinë e vet personit, në një familje tjetër, në një qendër të specializuar të qëndrimit ditor, ose në një institucion rezidencial;

1.3. **Këshillimi profesional** - proces sistematik dhe i programuar i ofrimit të informacionit, këshillave dhe udhëzimeve me qëllim që të ndihmohet individi, familja, grupi dhe komuniteti për të përmirësuar rrethanat sociale dhe ndër njerëzore;

1.4. **Ndihma materiale** - sigurimi i parave, strehimit të përkohshëm, ushqimit, pagesës së shpenzimeve mjekësore, veshmbathjes ose çfarëdo nevojë tjetër të domosdoshme urgjente për individin ose familjen, të cilët nuk kanë burim tjetër në dispozicion;

1.5. **Person në nevojë** - cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale, pa u kufizuar dhe atë për shkak:

1.5.1. se është fëmijë pa përkujdesje prindërore;

1.5.2. se është fëmijë në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror;

1.5.3. se është fëmijë me vështirësi në sjellje;

1.5.4. se është viktimë e abuzimit dhe keqtrajtimit, përfshirë atë fizik, psikologjik, seksual dhe lënien pas dore;

1.5.5. se është fëmijë në konflikt apo në kontakt me ligjin;

1.5.6. të marrëdhënieve të çrregulluara në familje;

1.5.7. të moshës së shtyrë;

1.5.8. të aftësisë së kufizuar fizike;

1.5.9. të aftësisë së kufizuar mendore;

1.5.10. të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi;

1.5.11. të dhunës në familje dhe çfarëdo lloji tjetër dhune në bazë gjinore;

1.5.12. të trafikimit me qenie njerëzore;

1.5.13. të përfshirjes së fëmijëve në punë të rënda;

1.5.14. të varësisë nga substancat psiko-aktive, siç janë: alkooli, drogat apo ndonjë lëndë tjetër natyrale apo farmaceutike që shkakton varësinë;

1.5.15. të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu; ose

1.5.16. të ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona në nevojë.

1.6. Familje në nevojë - familja kur njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit i nevojitet ndihma, apo rastet kur kërkohet përkujdesja për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës;

1.7. Profesionist i shërbimeve sociale - ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushën e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose të ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është licencuar dhe regjistruar në regjistër të Ministrisë, që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare nga fusha e përgjegjësisë dhe kompetencës së tyre profesionale;

1.8. Ministria - Ministria përkatëse për çështje sociale;

1.9. Komuna - Kryeqyteti Prishtina dhe komunat në Republikën e Kosovës;

1.10. Departamenti - Departamenti përkatës në Ministri për Politika dhe Shërbime Sociale dhe Familjare;

1.11. Këshilli Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare - mekanizimi për zhvillimin e programeve për trajnimin e vazhdueshëm profesional për ofruesit e shërbimeve sociale dhe licencimin e ofruesve individual për shërbime sociale dhe familjare.

1.12. Qendra për Punë Sociale - institucion social administrativ dhe profesional i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale;

1.13. Organi i Kujdestarisë - organi përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë;

1.14. Menaxheri i Rastit - zyrtari përgjegjës i caktuar nga Organi i Kujdestarisë, për menaxhimin e rastit, i cili në bashkëpunim me akterët relevant vlerëson nevojat e përfituesit dhe harton planin e përkujdesjes;

1.15. Kujdestari Ligjor - personi i caktuar me vendim të Organit të Kujdestarisë, i cili ka për obligim t'i përfaqësoj në mënyrë ligjore të drejtat dhe interesat e personit nën kujdestari.

1.16. **Paneli për Adopim** - nënkupton trupën profesionale të themeluar nga Ministria për Mbarëvajtjen dhe Monitorimin e Procesit të Adopimit Vendor dhe Ndërkombëtar;

1.17. **Paneli për Strehim Familjar** - trup profesionale i cili jep pëlqimin për vendosjen e fëmijës apo personit të rritur në strehim familjar brenda apo jashtë rrethit familjar, bazuar në vlerësimin e Organit të Kujdestarisë, të cilëve i'u sigurohet strehimi dhe përkujdesja nëpërmjet ofrimit të shërbimit social në rrethin familjar të familjes biologjike apo jashtë rrethit familjar të familjes biologjike;

1.18. **Paneli për strehim rezidencial** - trup profesionale në nivel qendror dhe lokal i cili jep pëlqimin për vendosjen e fëmijës, personit të rritur dhe të moshuar, në strehim rezidencial, bazuar në vlerësimin e Organit të Kujdestarisë, të cilëve i'u sigurohet strehimi dhe përkujdesja, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve sociale;

1.19. **Fëmijë** - personi deri në moshën 18 vjeç;

1.20. **I mitur** - personi në mes të moshës 14 - 18 vjeç;

1.21. **Madhor** - personi që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç;

1.22. **Të rinj** - personat deri sa të mbushin moshën 24 vjeç;

1.23. **Organizatat e shoqërisë civile** - organizata të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;

1.24. **Familja** - nënkupton familjen sipas dispozitave të Ligjit përkatës për Familjen në Kosovë.

1.25. **Prindi vetushqyes/vetmbajtës** - prindi i cili përkujdeset vetë për fëmijën e tij dhe e mbanë atë, përderisa prindi tjetër ka vdekur, apo është i panjohur, i zhdukur ose me vendbanim apo vendqëndrim të panjohur, i është marrë zotësia e veprimit apo e drejta prindërore, prind i shkurorezuar ose i ndarë.

1.26. **Person i vetëm** - personi i cili nuk është në bashkësi martesore apo jashtëmartesore, përkatësisht nuk ka familje dhe jeton i vetëm;

1.27. **Bashkësia jashtëmartesore** - bashkësia jetësore e gruas dhe burrit të cilët nuk kanë një martesë të ligjshme bashkë, e që i plotëson kushtet e parapara me ligjin e veçantë me të cilin rregullohen marrëdhëniet familjare;

1.28. **Përfitues i shërbimeve sociale dhe familjare** - individ, anëtarët e familjes dhe familja në tërësi, të cilët realizojnë të drejta dhe shërbime në pajtim me këtë Ligj;

1.29. **Person me aftësi të kufizuar** - personi që ka dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët;

1.30. **Gjendja pasurore** - të hyrat dhe pasuria e individit, personit të vetëm apo pasuria e familjes.

Neni 4 **Parimet**

1. Shërbimet sociale udhëhiqen nga parimi i:

1.1. respektimit të integritetit dhe dinjitetit të përfituesit të shërbimeve sociale, fëmijës apo të rriturit, i cili bazohet në drejtësinë sociale, përgjegjësinë dhe solidaritetin që ofrohet, duke respektuar integritetin fizik dhe psikik, të sigurisë, si dhe duke respektuar bindjet morale, kulturore dhe religjioze në pajtim me të drejtat dhe liritë njerëzore të garantuara;

1.2. mos diskriminimit të përfituesit sipas racës, gjinisë, moshës, përkatësisë kombëtare, religjionit, përkatësisë politike, sindikale apo të përcaktimit tjetër, të gjendjes pasurore, kulturës, gjuhës, aftësisë së kufizuar, përkatësisë së grupit të caktuar shoqëror, apo cilësive tjera personale dhe të vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve sociale;

1.3. informimit të përfituesit për të gjitha të dhënat të cilat janë të rëndësishme për përcaktimin e nevojave të tyre sociale dhe realizimit të të drejtave, si dhe për atë se si ato nevoja mund të përmbushen kënaqshëm;

1.4. qasjes individuale dhe të lehtë tek përfituesi në ofrimin e shërbimeve sociale për të gjithë ata që janë në nevojë sociale, ashtu që këto shërbime sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit me qëllim të sigurimit të mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve;

1.5. garantimit të pjesëmarrjes aktive të përfituesit në krijimin, zgjedhjen dhe shfrytëzimin e të drejtave sociale, i cili bazohet në pjesëmarrjen, vlerësimin e gjendjes dhe të nevojave, si dhe vendimmarrjes për pranimin e shërbimeve të nevojshme;

1.6. respektimit të interesit më të mirë të përfituesit në realizimin e të drejtës në shërbime sociale;

1.7. gjithë përfshirjes dhe pluralizmit të shërbimeve dhe i ofruesve të shërbimeve sociale sipas kushteve dhe mënyrës së paraparë me ligj;

1.8. transparencës në pikëpamje të përfshirjes së opinionit për mbrojtjen sociale në mjetet publike të informimit, si dhe në mënyra tjera në pajtim me ligjin;

1.9. respektimit të privatësisë me rastin e ofrimit të shërbimeve të përkuqdesjes sociale të përfituesit të të drejtave në sistemin e përkuqdesjes sociale.

1.10. fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, ashtu që përfituesit -e të drejtës në sistemin e kujdesit social duhet t'u sigurohet fshehtësia dhe mbrojtja e të dhënave personale në pajtim me ligjin.

1.11. vazhdimësisë së shërbimeve sociale, që nënkupton udhëzimin dhe përcjelljen e përfituesit përgjatë një periudhe kohore përmes një pakoje gjithëpërfshirëse të shërbimeve që mbulon çdo nivel dhe intensitet të kujdesit shëndetësor dhe social që një personi mund t'i duhen gjatë gjithë jetës;

1.12. mos bërjes dëm, që nënkupton se shërbimet sociale duhet të ofrohen duke u bazuar në kuptimin e kontekstit në të cilin problemet sociale të ngritura bëhen nëpërmjet një vlerësimi se si intervenimi mund të ndër veprimë kundrejt një vendimi për të ofruar shërbimet sociale duke shmangur ndikimin negativ, dhe duke arritur ndikim pozitiv;

1.13. personit dhe familjes në qendër, nënkupton që shërbimet sociale duhen ofruar duke i'u përshtatur nevojave të secilit përfitues, duke zhvilluar plan të intervenimit individual për çdo rast në harmoni me kompleksitetin e rastit;

1.14. ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të integruara, që ofrohen nëpërmjet vlerësimit të cenueshmërisë së shumëfishtë të përfituesit si individ apo në grup;

1.15. vlerësimit dhe gatishmërisë për të ofruar kualitet, që nënkupton se shërbimet sociale duhen zhvilluar me një qasje sistematike për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve të ofruara, si dhe metodologjinë për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të programeve të reja.

KAPITULLI II

SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

Neni 5

Shërbimet sociale dhe familjare

1. Shërbimet sociale dhe familjare synojnë:

1.1. ofrimin e ndihmës ndaj individit, familjes, grupit dhe komunitetit, pavarësisht moshës, aftësisë së kufizuar, problemeve sociale, që pjesërisht apo plotësisht, përkohësisht apo përherë kanë humbur aftësinë apo mundësinë për t'u kujdesur në mënyrë të pavarur për jetën e tyre private apo të familjes si dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri;

1.2. krijimin e kushteve për zhvillimin dhe fuqizimin e individit dhe familjes për aftësim dhe mundësi që në mënyrë të pavarur të zgjidhin problemet sociale, mbajtjen e lidhjeve me shoqërinë, si dhe për të tejkaluar përjashtimin shoqëror;

1.3. fuqizimin e familjes dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja e tij, nëpërmjet shërbimeve që mundësojnë ndërtimin dhe ruajtjen e unitetit të familjes, e nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të mundësojë vendosjen e fëmijës në ambient familjar, duke u kujdesur për të drejtat, mirëqenien dhe në interesin më të mirë të fëmijës.

2. Qeveria dhe komunat sigurojnë dhe ofrojnë shërbimet sociale dhe familjare në pajtim me ligjin.

3. Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare nga paragrafi 2 i këtij neni mund t'i besohet edhe personave tjerë fizik dhe juridik të licencuar sipas këtij ligjit.

4. Komuna mund të përcaktoj dhe ofroj shërbime sociale dhe familjare të tjera në pajtim me nevojat e popullsisë së komunës përkatëse, si në vijim:

- 4.1. ndihmë personale për personin me aftësi të kufizuar;
- 4.2. mbështetje me banim;
- 4.3. strehimi i mbrojtur dhe i sigurt;
- 4.4. ndihmë në përkujdesjen e personave madhor pas lëshimit nga institucionet apo të familjeve strehuese;
- 4.5. ndihma e njëhershme në naturë e cila jepet në situata emergjente;
- 4.6. shërbime të kuzhinës publike;
- 4.7. ndihmë për shkollim të fëmijës dhe të familjes në nevojë sociale;
- 4.8. ndihmë në edukim dhe arsimim të fëmijës me nevoja të veçanta arsimore;
- 4.9. subvencionimi i shpenzimeve komunale për familjen e varfër;
- 4.10. ndihmë në përkujdesjen banesore të familjes dhe individit të varfër si dhe atyre në nevojë;
- 4.11. shpenzimet e varrimit të përfituesit të të drejtave nga ky Ligj;
- 4.12. shërbimet e mbështetjes nëpërmjet linjës 24 orë të telefonit;
- 4.13. subvencionimi i shërbimeve të transportit lokal, dhe
- 4.14. të drejta tjera dhe shërbime ndaj nevojave të qytetarëve të komunës përkatëse.

5. Të drejtat sipas këtij Ligji realizohen pasi që të shterojnë mundësitë e disponueshme të individit apo familjes. Shërbimet sociale dhe familjare ofrohen me qëllim të parandalimit të problemeve sociale të individit, familjes, grupit dhe komunitetit, si dhe garantimit të mirëqenies dhe kohezionit social të familjes dhe të shoqërisë.

Neni 6 **Përfituesit e shërbimeve sociale**

1. Përfituesit e shërbimeve sociale dhe familjare janë individit, anëtari i familjes dhe familja në tërësi, të cilët realizojnë të drejta dhe shërbime në pajtim me ligjin.

2. Të drejtat e përfituesve të shërbimeve sociale realizohen përmes mbështetjes financiare, me shërbime sociale dhe me masa tjera të cilat i ofrohen individit, anëtarit të familjes apo familjes.

Neni 7

Trajtimi i barabartë

1. Përfituesi i shërbimeve sociale ka të drejtë në mbrojtje sociale, e cila bazohet në trajtim të barabartë dhe të drejtë.
2. Ndalohet çdo formë e diskriminimit në realizimin e mbrojtjes sociale dhe shërbimeve sociale si dhe familjare.

Neni 8

Ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare janë Qeveria dhe Komunitatet.
2. Shërbimet sociale dhe familjare, përveç institucioneve publike të shërbimeve sociale mund t'i ofrojnë edhe organizatat joqeveritare, personat fizik e juridik në pajtim me ligjin.
3. Qeveria përcakton sistemin e shërbimeve sociale, harton politika dhe strategji zhvillimore, të drejtat dhe kriteret për përfituesit e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe siguron realizimin e të drejtave të parapara me ligj.
4. Komunitatet:
 - 4.1. zbaton politikën, strategjitë dhe standardet e përcaktuara nga Qeveria;
 - 4.2. harton planin vjetor dhe afatmesëm të shërbimeve sociale, në bazë të analizës së gjendjes sociale dhe nevojave të popullsisë në territorin e saj;
 - 4.3. vendos për të drejtat e përcaktuara me këtë ligj, si dhe përcakton kushtet për realizimin e të drejtave, masave dhe programeve;
 - 4.4. siguron mjetet për realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligj;
 - 4.5. kryen edhe punë të tjera në realizimin e qëllimeve të mbrojtjes sociale dhe familjare.

Neni 9

Nevojat themelore jetësore

1. Nevojat themelore jetësore janë ushqimi, uji, strehimi, veshmbathja, përkujdesja, sendet e domosdoshme shtëpiake, ngrohja, dhe nevojat shëndetësore, për të siguruar minimumin e jetesës, ndërsa përfshijnë edhe pjesëmarrjen në jetën në komunitet dhe përfshirje sociale.
2. Tek fëmijët dhe personat madhor, nevojat personale jetësore përfshijnë edhe nevojat të cilat dalin nga zhvillimi i tyre, rritja, përkujdesi, edukimi dhe arsimimi.
3. Tek fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, përveç nevojave jetësore themelore, ekzistojnë edhe nevojat plotësuese të cilat dalin nga aftësia e kufizuar fizike dhe mendore,

përkatësisht, aftësitë e kufizuara të shumëfishta, me qëllim të përfshirjes së tyre aktive në jetën e përditshme të bashkësisë në baza të barabarta me të tjerët.

Neni 10

Përgjegjësia për përmbushjen e nevojave jetësore

Secili person kujdeset për plotësimin e nevojave jetësore të tij dhe të nevojave të personave tjerë në pajtim me ligjin.

Neni 11

Personat që gëzojnë të drejtën për shërbime sociale dhe familjare

1. Të drejtën për shërbime sociale dhe familjare e gëzojnë:

- 1.1. shtetasit e Republikës së Kosovës me vendbanim në territorin e Kosovës;
- 1.2. shtetasi i huaji me vendqëndrim të përkohshëm të lejuar apo me vendqëndrim të përhershëm në Kosovë;
- 1.3. personi me status të azilkërkuesit dhe i huaji nën mbrojtjen subsidiare në pajtim me ligjin.

2. Të drejtat nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i gëzojë edhe personi, i cili për shkak të rrethanave të posaçme dhe të rrezikut është e nevojshme t'i ofrohet forma përkatëse e mbrojtjes, duke pasur të drejtën e ndihmës së njëhershme në të holla dhe në shërbim të strehimit të përkohshëm.

Neni 12

Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare sa me efikase dhe efektive, institucionet e nivelit qendror dhe lokal bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet mes tyre dhe me akterët e tjerë që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

2. Komunat marrin pjesë në financim të shërbimeve sociale dhe familjare në bashkëpunim dhe bashkërendim nder komunal.

Neni 13

Kufizimi i realizimit të të drejtave në shërbime sociale dhe familjare

1. Të drejtat në shërbime sociale dhe familjare të përcaktuara me këtë ligj nuk mund t'i realizojë personi i cili të drejtën e tillë e shfrytëzon sipas dispozitave tjera ligjore.

2. Të drejtat për kujdesin dhe shërbimet sociale janë personale dhe nuk mund të barten dhe as të trashëgohen.

3. Ndhimja financiare e cila realizohet në pajtim me këtë ligj, nuk mund të jetë objekt i sigurimit apo përmbarimit të detyrueshëm.

KAPITULLI III

E DREJTA NË SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE, KLASIFIKIMI DHE FORMAT E MBROJTJES

Neni 14

E drejta në shërbimet sociale dhe familjare

1. Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë aktivitete, masa dhe programe të destinuara për parandalimin, identifikimin, mbrojtjen, rehabilitimin, riintegrimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe të vështirësive të individit dhe familjes, si dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre në bashkësi.
2. Shërbimet sociale dhe familjare mund të ofrohen përkohësisht apo për një periudhë të gjatë, varësisht nga nevojat e përfituesit dhe organizohen si shërbime për fëmijë, të rinj, familje dhe për persona të rritur dhe të moshuar duke respektuar lidhjet sociale, të rrethit të përfituesve dhe të familjes.
3. Varësisht nga nevojat e përfituesit, shërbimet sociale mund të ofrohen njëkohësisht dhe në mënyrë të kombinuar me shërbimet të cilat i ofrojnë institucionet arsimore, shëndetësore dhe ofruesit tjerë të shërbimeve (në tekstin e mëtejshëm: shërbimet e integruara).
4. Shërbimet e integruara rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.

Neni 15

Vlerësimi dhe planifikimi i shërbimeve

1. Vlerësimi përfshinë vlerësimin e gjendjes së përfituesit të shërbimeve, të nevojave, aftësinë, cënueshmërinë, të rrezikut, dhe të personave tjerë në rrethin familjar dhe shoqëror të rëndësishëm për përfituesit, vlerësimin e kujdestarit, personit përkujdesës ose adoptuesit.
2. Planifikimi përfshin planifikimin e shërbimeve me qëllim të përfitimit nga këto shërbime apo të caktimit të masave të mbrojtjes për përfituesin, familjen dhe komunitetin.
3. Veprimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni i siguron Ministria dhe komuna, ndërsa ofrimi i shërbimeve sociale bëhet nga Qendra për Punë Sociale, organizatat jo qeveritare, personat juridik ofruesit privat dhe ofruesit individual në pajtim me ligjin.
4. Vlerësimin dhe planifikimin me rastin e ofrimit të shërbimeve, e kryejnë ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare në pajtim me ligjin.

Neni 16

Klasifikimi i shërbimeve sociale

1. Shërbimet sociale dhe familjare klasifikohen në kategori të shërbimeve parësore, dytësore dhe tretësore, ku secila kategori ka qëllim të ndryshëm.
2. Ministria dhe komuna është përgjegjëse për të siguruar që shërbimet e mjaftueshme sociale të secilës prej tri kategorive t'iu përgjigjen nevojave të përfituesit në të gjithë territorin e vendit.

Neni 17

Shërbimet parësore

1. Shërbimet parësore janë shërbime parandaluese, të përgjithshme të qasshme ose të ofruara si ndërhyrje e hershme në familjen dhe komunitetin ku jeton përfituesi.
2. Shërbimet sociale parësore ofrohen në një mënyrë të synuar, të destinuar ose të mbështetur financiarisht për të zvogëluar cenueshmërinë e përfituesit të identifikuar si të përshtatshëm.
3. Shërbimet parësore përfshijnë, por pa u kufizuar në:
 - 3.1. këshilla për informim si një shërbim të ofruar me qëllim që t'i ndihmohet individit të marrë informacione se si mund ta ndihmojnë vetveten ose të kenë qasje në përkrahje diku tjetër;
 - 3.2. këshillimin konsultativ, terapeutik ose mentorimi, i cili synon përmirësimin e situatës së një individi duke përdorur teknikat terapeutike dhe teknikat e mbështetjes psiko-sociale të zakonshme në fushën e psikologjisë;
 - 3.3. edukimin prindëror që synon të ndihmojë prindërit të përvetësojnë njohuri dhe ndërgjegjësim më të madh mbi fazat e zhvillimit të fëmijës, teknikat efektive të komunikimit në familje dhe disiplinat pozitive;
 - 3.4. mbështetjen për strehim, i cili siguron banim të rezervuar ose të mbështetur financiarisht për t'iu mundësuar individëve të qëndrojnë ose të përfshihen në aspektin social dhe të zhvillojnë një jetë funksionale;
 - 3.5. shërbimet e kujdesit ditor në familje dhe komunitet, përfshijnë aktivitete të cilat mbështesin qëndrimin e përfituesit në familje dhe në rrethin e drejtpërdrejtë, përkatësisht në komunitet;
 - 3.6. mentorimin e aktiviteteve profesionale për të ndihmuar një person të kërkojë punë;
 - 3.7. shërbimet ligjore nga një profesionist me përvojë apo nga institucioni përkatës për ofrimin e ndihmës juridike falas në çështje juridike për të ndihmuar përfituesin të zgjidh çështje të natyrës ligjore.
 - 3.8. kujdesi dhe ndihma në shtëpi, e cila ofrohet në shtëpinë e personit që merr ndihmën, është shërbim që mund të përfshijë furnizimin me ushqim, kryerjen e punëve

të shtëpisë, furnizimi me ilaçe, dhënien e terapisë, mirëmbajtjen e higjienës në dhomë, kryerjen e punës në komunitet, si dhe plotësimin e nevojave të tjera ditore;

3.9. shërbimet e transportit mund t'i ofrohen një personi me lëvizshmëri të kufizuar për ta ndihmuar këtë person të shfrytëzoj shërbimet tjera ose të lëvizë për të qenë i përfshirë në shoqëri.

Neni 18 **Shërbimet dytësore**

1. Shërbimet dytësore janë shërbime të specializuara sociale për trajtimin dhe rehabilitimin e personit që merr shërbimin, i cili është në rrezik ose i janë shkelur të drejtat. Këto shërbime janë të nevojshme për trajtimin dhe rehabilitimin duke zvogëluar rrezikun dhe duke adresuar ndikimet negative të përvojave të pafavorshme, siç janë trauma dhe dhuna.

2. Shërbimet ofrohen sa më afër vendbanimit të përfituesit, ose me kërkesë të përfituesit dhe për qëllime të garantimit të fshehtësisë së përfituesit në një vend ku përfituesi zgjedh, në komunën e vendbanimit ose vendqëndrimit.

3. Shërbimet dytësore përfshijnë, por pa u kufizuar:

3.1. shërbimet e këshillimit terapeutik të specializuara sociale ku trajtohen rastet e paraqitura si: trauma, depresioni, mendimet vetëvrasëse, etj;

3.2. shërbimet e riintegritit dhe përgatitja për shërbime dhe programe të jetesës së pavarur që përfshijnë një sërë masash, siç janë: gjurmimi, këshillimi, planifikimi i hapave të riintegritit dhe mbështetja që duhet të ofrohet gjatë realizimit të këtyre hapave, lidhja dhe ndërlidhja me ofruesit e tjerë të shërbimeve dhe ribashkimi i një personi me vendbanimin e tij natyror derisa personi të integrohet plotësisht dhe në mënyrë të sigurt në familje ose komunitet;

3.3. programi dhe trajtimi i abuzimit me substanca;

3.4. shërbimet e mentorimit janë shërbime këshillimi për të ndihmuar në tejkalimin e rreziqeve dhe zvogëlimin e rrezikut.

Neni 19 **Shërbimet tretësore**

1. Shërbimet tretësore janë shërbime sociale të kujdesit të vazhdueshëm dhe intensiv të ofruara 24 orë në ditë gjatë gjithë javës për personat në rrezik ose viktimat. Personi qëndron për një periudhë më të shkurtër ose më të gjatë për trajtim ose rehabilitim.

2. Shërbimi ofrohet sa më afër vendbanimit të përfituesit por jo domosdoshmërisht në të njëjtën komunë

3. Shërbimet tretësore përfshijnë, por pa u kufizuar:

3.1. strehimi familjar brenda apo jashtë familjes biologjike ku fëmijës ose të rriturit i sigurohet strehim dhe kujdes në mjedis familjar. Shërbimet e banimit përfshijnë pritjen, banimin, ushqimin, veshmbathjen, higjienën, kujdesin në dhomë, kujdesin për shëndetin, kujdestarinë, edukimin, aktivitetet e punës, rehabilitimin psiko-social dhe kohën e lirë;

3.2. shtëpi në grupe të vogla si një formë e kujdesit dhe mbrojtjes alternative jashtë familjes biologjike.–Shërbimet përfshijnë pritjen, banimin, ushqimin, veshmbathjen, higjienën, kujdesin në dhomë, shëndetin dhe kujdesin, kujdestarinë, edukimin, aktivitetet e punës, rehabilitimin psiko-social dhe kohën e lirë;

3.3. qendra e pranimit një strehimore e siguar si banim i përkohshëm i organizuar për individët, të afërmit e tyre të gjakut ose familjen strehuese, të cilët janë në situata të vështira ose emergjente, derisa të dërgohen në një shërbim tjetër profesional. Këto shërbime përfshijnë pritjen, banimin, ushqimin, veshmbathjen, higjienën, kujdesin në dhomë, shëndetin dhe kujdesin, kujdestarinë, edukimin, aktivitetet e punës, rehabilitimin psiko-social dhe kohën e lirë;

3.4. banimi mbështetës në shtëpitë në grupe si një formë e veçantë e banimit ku shërbimet mbështetëse ofrohen për deri në pesë (5) persona të cilët qëndrojnë së bashku 24 orë në ditë, dhe atyre i'u ofrohet mbështetje e përhershme ose e përkohshme profesionale dhe e organizuar në mënyrë që të përmbushin nevojat themelore jetësore në afat të shkurtër ose të gjatë.

Neni 20

Shërbimet dhe format e mbrojtjes

1. Shërbimet e mbrojtjes për përfituesin sigurohen përmes këtyre formave:

1.1. kujdestarisë;

1.2. strehimit familjar, i cili përshinë strehimin familjar tek të afërmit dhe strehimin familjar në familjen tjetër për fëmijë, persona të rritur në nevojë dhe të moshuar;

1.3. strehimit rezidencial të përfituesit, përfshirë lloje të ndryshme të shtëpive apo qendrave, shtëpive me bazë në komunitet (në tekstin e mëtejshëm: strehimi rezidencial), vendeve për pranim dhe lloje tjera të strehimit në pajtim me ligjin;

1.4. adoptimit, si formë e përhershme e mbrojtjes juridike dhe familjare për fëmijën pa kujdes prindëror;

1.5. jetesës së pavarur të mbikëqyrur.

Neni 21

Kujdestaria

1. Kujdestaria është formë e mbrojtjes për fëmijën pa kujdes prindëror, i cili vendoset në kujdestari dhe gëzon mbrojtje të veçantë nga institucionet publike, kur prindërit e tij e kanë të pamundur të ushtrojnë përkujdesjen prindërore, pa u kufizuar vetëm në shkaqet se të dy

prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur të zhdukur, i'u është hequr kujdesi prindëror ose kanë humbur aftësinë për të vepruar, apo për çdo shkak tjetër i cili me vendim të gjykatës jep arsye për vendosje në të mirë të mirëqenies së fëmijës.

2. Kujdestaria si formë e mbrojtjes ofrohet ndaj personit të moshës madhore, të cilit i hiqet aftësia për të vepruar me vendim të gjykatës.

3. Kujdestaria për raste të veçanta caktohet për shkak të pasurisë së pa definuar (kujdestari speciale), në emër të pasurisë së supozuar të personit, në rastet kur pronari i pasurisë është i panjohur dhe kur personi i tillë nuk ka përfaqësues ligjor, si dhe kur kujdestaria është e paevitueshme për të mbrojtur interesat ligjore të personit.

4. Kujdestaria e veçantë caktohet për fëmijën në rastet kur prindërit ushtojnë kujdesin prindëror, mirëpo mes tyre dhe fëmijës ekziston kontest për punë juridike të dukshme që kanë të bëjnë me pasurinë e fëmijës.

5. Procedura për caktimin e kujdestarisë, llojet e kujdestarisë dhe çështje të tjera lidhur me kujdestarinë rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 22 **Strehimi familjar**

1. Strehimi familjar është formë e mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimit social jashtë familjes biologjike dhe tek të afërmit me të cilën fëmijës apo personit të rritur i sigurohet strehimi dhe përkujdesja para së gjithash në rrethin familjar në pajtim me ligjin.

2. Strehimi për fëmijë dhe të rinj përfshinë edhe përgatitjen për kthimin tek prindërit, rregullim tjetër të përhershëm jetësor dhe përgatitjen për jetë të pavarur.

3. Strehimi i personave të rritur mundëson mbajtjen apo përmirësimin e kualitetit të jetës për t'ua siguruar kushtet e domosdoshme për zhvillimin, edukimin dhe aftësimin e tyre për jetë dhe për punë të pavarur.

4. Strehimi i përfituesit të shërbimeve mund të jetë i përkohshëm, ditor dhe afatgjatë.

5. Shërbimet e strehimit përfshijnë shërbimet e pranimit, të banimit, ushqimit, sigurimit të veshmbathjes, mbajtjes së higjienës në dhomë, kujdesit për shëndetin dhe përkujdesjen, mbrojtjen, edukimin dhe arsimimin, zhvillimin e aktiviteteve punuese, të rehabilitimit psiko-social, riintegritit dhe të organizimit të kohës së lirë.

6. Përfituesit të shërbimit të strehimit me plan individual i përcaktohet lloji i shërbimeve të cilat i shfrytëzon gjatë strehimit, varësisht prej nevojave të përcaktuara dhe zgjedhjes së përfituesit.

7. Shërbimet e strehimit familjar përfshijnë edhe përgatitjen e përfituesit për kthim në familjen e tij, apo vendosjen në ndonjërin prej formave tjera të mbrojtjes.

8. Shërbimet e strehimit i siguron Ministria dhe komuna ndërsa i ofrojnë Qendrat për Punë Sociale, organizatat joqeveritare dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë, të cilat kryejnë veprimtarinë e shërbimeve sociale dhe familjare në pajtim me këtë ligj.

9. Paneli për strehim familjar funksionon në kuadër të Departamenti përkatës në Ministri, i cili emërohet nga Ministri prej pesë (5) anëtarëve, me përbërje tre (3) përfaqësues nga Departamenti përkatës në Ministri, një (1) përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale dhe një (1) përfaqësues nga organizatat joqeveritare.

10. Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për strehim familjar përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

11. Shërbimet e strehimit mund të ofrohen edhe si shërbime të integruara sociale ndër sektoriale.

12. Ofruesi i shërbimeve të strehimit familjar kompensohet sipas kontratës.

13. Kushtet për marrjen e shërbimit të strehimit, llojet e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur, si dhe çështje të tjera lidhur me strehim, rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 23

Ofruesit e shërbimeve të strehimit familjar

1. Shërbimet për strehimin familjar me përparësi e ofrojnë të afërmit familjar, kur kjo është në interesin më të mirë të përfituesit.

2. Shërbimet për strehimin familjar i ofron familja strehuese apo personi tjetër që është vlerësuar i përshtatshëm, i cili i ka përfunduar trajnimet me sukses, si dhe i plotëson kushtet e tjera të përcaktuara me ligj.

3. Familja, përkatësisht personi nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, marrin trajnime përkatëse, ndërsa gjatë ofrimit të shërbimeve edhe mbështetjen në pajtim me ligjin.

Neni 24

Strehimi rezidencial

1. Strehimi rezidencial është formë e mbrojtjes së fëmijës pa kujdes prindëror, të rriturit dhe të moshuarit pa kujdes familjar, i cila sigurohet nëpërmjet banimit dhe plotësimit të nevojave themelore jetësore, si dhe mbrojtjes shëndetësore të përfituesit i cili nuk ka kushte për të qëndruar në familje dhe të cilit nuk mund t'i sigurohet shërbimi social nëpërmjet strehimit familjar dhe shërbimit në familje.

2. Përjashtimisht, kur format e tjera të strehimit dhe të kujdesit nuk mund të sigurohen dhe situata e nevojës për mbrojtje për fëmijën është emergjente, fëmija vendoset përkohësisht në strehim rezidencial për fëmijë.

3. Ambientet që ofrojnë strehim rezidencial duhet të jenë të vogla dhe të organizuara mirë për mbrojtjen e të drejtave dhe plotësimin e nevojave të fëmijës në ambiente që i ngjasojnë sa më shumë mjediseve familjare.

4. Paneli për strehim rezidencial funksionon në kuadër të Departamenti përkatës në Ministri, i cili emërohet nga Ministri prej tre (3) anëtarëve, me përbërje dy (2) përfaqësues nga Departamenti përkatës në Ministri, një (1) përfaqësues nga institucionet e përkujdesit rezidencial.
5. Paneli për strehim rezidencial në nivel lokal funksionon në kuadër të Komunës, i cili emërohet nga Komuna prej tre (3) anëtarëve, me përbërje një (1) përfaqësues nga Drejtorati komunal përkatës, një (1) përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale dhe një (1) përfaqësues nga institucioni i përkujdesit rezidencial.
6. Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për strehim rezidencial përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.
7. Përveç nevojave nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, sigurohet edhe qasja në arsim dhe aspekte tjera që ndikojnë në zhvillimin e kapaciteteve psiko - fizike të fëmijës.
8. Shërbimet e strehimit rezidencial i ofrohen përfituesit që t'i sigurojnë përgatitjen për kthimin e tij në familjen biologjike, strehimin në familje tjetër, përkatësisht, përgatitjen e tij për jetë të pavarur në pajtim me burimet familjare, nevojat dhe interesin më të mirë të tij.
9. Me rastin e zgjedhjes për të drejtën e përfituesit në strehim rezidencial, organet kompetente shqyrtojnë të gjitha mundësitë e tjera dhe llojet e shërbimeve jashtë strehimit rezidencial, dhe strehimin rezidencial e aplikojnë kur nuk ekziston mundësi tjera, veçmas me kujdes të shuar për fëmijët nën moshën 3 vjeçare.
10. Shërbime të strehimit rezidencial mund të ofrojnë ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare, i cili e ka marrë licencën dhe pëlqimin për ofrimin e këtyre shërbimeve.
11. Kushtet për ofrimin e strehimit rezidencial, llojet e strehimit, kushtet për kryerjen e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur, rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 25

Strehimi në situata emergjente

1. Me strehim në qendrën emergjente të pranimit, përfituesit i sigurohet strehimi dhe siguria për një periudhë të shkurtër kohore, deri në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për situatat e krizës, plotësimin e nevojave themelore të tij dhe qasje në shërbime tjera.
2. Shërbimin e strehimit në qendrën e pranimit e siguron Ministria dhe komuna, ndërsa shërbimin e ofrojnë institucionet e shërbimeve sociale, organizatat joqeveritare edhe personat e tjerë fizik e juridikë të licencuar.

Neni 26

Shërbimet e intervenimeve emergjente

1. Shërbimet sociale mund të ofrohen në formën e intervenimeve emergjente me qëllim të garantimit të sigurisë në situatat të cilat e rrezikojnë jetën, shëndetin dhe zhvillimin e përfituesit dhe sigurohen 24 orë në ditë.

2. Shërbimet e intervenimeve emergjente i siguron Ministria dhe komuna ndërsa i ofron Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me organet dhe akterët e tjerë kompetent.

Neni 27

Adoptimi dhe procedura

1. Adoptimi është formë themelore e përhershme e mbrojtjes juridike dhe familjare, që i ofrohet fëmijës pa kujdes prindëror, që nënkupton bartjen e përhershme të të drejtave dhe përgjegjësisë prindërore tek prindi/prindërit adoptues;

2. Adoptimi, është i lejuar nëse i shërben interesit më të mirë të fëmijës dhe nëse pritet që mes prindit apo prindërve adoptues dhe fëmijës do të krijohet marrëdhënia prind-fëmijë që nënkupton themelimin e njëjtë të të drejtave dhe detyrimeve që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijës;

3. Shërbimet sociale dhe familjare në procesin e adoptimit ofrohen nga organi i kujdestarisë për vlerësimin profesional të nevojave të fëmijës së mundshëm për adoptim dhe vlerësimin profesional të personave të mundshëm adoptues, si dhe të përshtatshmërisë së tyre për adoptim të fëmijës, para marrjes së vendimit nga gjykata.

4. Organi i Kujdestarisë përgatitë dhe ofron mendim profesional gjatë marrjes së vendimit nga gjykata mbi adoptimin.

5. Paneli për Adoptim ofron mendim profesional për adoptim vendor dhe pëlqim për adoptim ndërkombëtar të fëmijës, i cili pëlqim i dërgohet gjykatës para marrjes së vendimit nga gjykata.

6. Paneli për Adoptim mban regjistrin e fëmijëve dhe familjeve të cilët janë të vlerësuar nga Organi i Kujdestarisë dhe të cilët i plotësojnë kushtet për adoptim.

7. Paneli për adoptim funksionon në kuadër të Departamenti përkatës në Ministri, i cili emërohet nga Ministri prej pesë (5) anëtarëve, me përbërje tre (3) përfaqësues nga Departamenti përkatës në Ministri, një (1) përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale dhe një (1) përfaqësues nga organizatat joqeveritare.

8. Organizimi detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit për adoptim përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

9. Procedurat për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e adoptimit rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 28

Jetesa e pavarur e mbikëqyrur dhe aftësimi për jetë dhe punë të pavarur

1. Jetesa e pavarur e mbikëqyrur është një formë e mbrojtjes dhe e kujdesit alternativ si vazhdim i mbështetjes për fëmijën që ka qenë pjesë e çdo forme të kujdesit alternativ për të forcuar aftësitë e tij për jetesë të pavarur në një mjedis të sigurt dhe mbështetës.

2. Jetesa e pavarur e mbikëqyrrur si shërbim ofrohet gjatë qëndrimit në strehim familjar dhe strehim rezidencial nga organizata joqeveritare, personat fizik e juridik me kapacitete profesionale për ofrimin e shërbimeve.
3. Jetesa e pavarur e mbikëqyrrur është një shërbim 24 orë çdo ditë gjatë javës që mund të ofrohet të afat të shkurtër ose të gjatë.
4. E drejta për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur i takon edhe personit me aftësi të kufizuar me pajtim me ligjin.
5. Fëmija deri në moshën 18 vjeç e gëzon këtë të drejtë në radhë të parë.
6. I rrituri i cili nuk është në gjendje të punojë për shkak të aftësisë së kufizuar dhe i cili nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për shpenzimet e tij jetësore, do t'i sigurohet mbështetje institucionale dhe sociale derisa të përfundojë një situatë e tillë.
7. E drejta për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur mund të ushtrohet nga personat e moshuar, nëse për shkak të arsyeve të caktuara nuk kanë mundur të përfundojnë aftësimin për jetesë të pavarur.
8. Të rinjtë mund të ushtrojnë të drejtën e aftësimin për jetesë dhe punë të pavarur vetëm pas vlerësimit të komisionit profesional. të tjera të kujdesit alternativ dhe për të cilin nuk është gjetur zgjidhje pas kujdesit afatgjatë, pasi të ketë arritur moshën madhore, do të vazhdojë të marrë mbështetje institucionale dhe sociale për të paktën tre vitet e ardhshme.
9. Pas periudhës trevjeçare, mbështetja mund të vazhdohet për një periudhë të caktuar, për raste specifike pas një rivlerësimi të nevojave të individit nga organi kompetent, por jo më shumë se 26 vjeç. Kjo mbështetje do të vazhdojë të ofrohet deri në moshën 26 vjeç, nëse ai është duke ndjekur edukimin e tij.
10. E drejta për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur, i'u sigurohet përfituesve përmes ofruesit përkatës të shërbimeve.
11. Procedura për përcaktimin e fakteve dhe ekzistencën e bazës për realizimin e të drejtave për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur, kryhet nga organi i kujdestarisë.
12. Personi i aftësuar për jetesë dhe punë të pavarur ka të drejtë për kompensim monetar gjatë kohës së punësimit.
13. Procedura për përcaktimin e fakteve dhe ekzistencën e bazës për realizimin e të drejtave për aftësim për jetesë dhe punë të pavarur duhet të fillojë më së largu me arritjen e moshës 16 vjeçare, dhe kryhet profesionalisht nga organi i kujdestari në bashkëpunim me kujdestarin ligjor, familjen strehuese apo institucionin rezidencial.
14. Organi i kujdestarisë përcakton kategoritë përkatëse për fëmijën dhe të riun që do të përfitojnë nga kjo formë e mbështetjes.
15. Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e mbështetjes së jetesës së pavarur dhe të mbikëqyrrur dhe aftësimin për jetën dhe punën e pavarur, rregullohet me akt nënligjor të nxjerr Ministri.

KAPITULLI IV PËRFITUESIT E SHËRBIMEVE SOCIALE

Neni 29 Përfituesit e të drejtave nga shërbimet sociale

1. Përfituesit e shërbimeve sociale janë shtetasit e Republikës së Kosovës me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Kosovës, apo personi tjetër i cili për çfarëdo arsye gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, i cili gjendet në gjendje të nevojës, gëzon të drejtën, duke mos u kufizuar vetëm në rastet si në vijim:

1.1. Fëmija:

1.1.1. pa përkujdesje prindërore;

1.1.2. i lënë pas dore;

1.1.3. i keqtrajtuar;

1.1.4. në konflikt apo kontakt me ligjin;

1.1.5. zhvillimi i të cilit është penguar nga rrethanat familjare;

1.1.6. me aftësi të kufizuar fizike, mendore dhe intelektuale apo shqisore afatgjata;

1.1.7. viktimë e dhunës në familje, me bazë gjinore dhe formave tjera të dhunës;

1.1.8. viktimë e trafikimit me njerëz;

1.1.9. viktimë e keqpërdorimit të substancave narkotike, psiko-aktive dhe të formave tjera të varësisë;

1.1.10. i përfshirë në punë të rënda;

1.1.11. i pa shoqëruar, si përgjatë migrimit, zhvendosjes si pasojë e luftërave apo tërmeteve;

1.1.12. apo, të cilit për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet formë përkatëse e kujdesit social;

1.2. Personi madhor:

1.2.1. me aftësi të kufizuar fizike, mendore dhe intelektuale apo shqisore afatgjata;

1.2.2. materialisht i pasiguruar dhe në gjendje të varfërisë;

1.2.3. i rrituri dhe i moshuari pa përkujdesje familjare;

1.2.4. me sjellje negative shoqërore;

1.2.5. viktimë e dhunës në familje, me bazë gjinore dhe të formave tjera të dhunës dhe abuzimit;

1.2.6. viktimë e trafikimit me qenie njerëzore;

1.2.7. përdorues i substancave narkotike, psiko-aktive dhe të formave tjera të varësisë;

1.2.8. i pastrehë;

1.2.9. të cilit për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet forma përkatëse e shërbimit social;

1.2.10. prind i ri në nevojë me fëmijë nën 3 vjeç, e sipas nevojës edhe pas kësaj moshe.

2. Shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni në pajtim me ligjin.

Neni 30

Fëmija përfitues i shërbimeve sociale

1. Fëmija përfitues i shërbimit social, përfshinë fëmijën:

1.1 pa përkujdesje prindërore, i cili është pa të dy prindërit, është i prindërve të panjohur, i braktisur nga prindërit, i prindërve të cilëve iu është marrë e drejta që të jetojnë me fëmijën, i prindërve të cilët janë privuar nga e drejta prindërore dhe fëmija i prindërve të penguar që të kryejnë detyrën prindërore si të burgosur, hospitalizuar, në arrati, me punë të përkohshme jashtë vendit, fëmija i prindërve të zhdukur, fëmija i prindërve me sëmundje apo ç'rregullime të rënda mendore, si dhe fëmija pa shtëpi;

1.2. i lënë pas dore, i cili për shkak të mbikëqyrjes dhe përkujdesit të pamjaftueshëm të prindërve apo kujdestarëve, dhe të ndikimit negativ të mjedisit ka nevojë për mbrojtje;

1.3. që ka braktisur shkollimin dhe edukimin e rregullt, i cili është në konflikt me ligjin dhe i cili me sjelljen e tij shkel normat e përgjithshme të pranuar, duke përfshirë edhe fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale;

1.4. zhvillimi i të cilit është penguar nga rrethanat familjare, prindërit e të cilit nuk janë në gjendje që t'i sigurojnë kushte normale për zhvillim fizik, psikik dhe emocional, si dhe edukim të drejtë;

1.5. me aftësi të kufizuar;

1.6. viktimë e dhunës në familje, me bazë gjinore dhe formave tjera të dhunës, viktimë e dhunës fizike, psikike ose seksuale dhe të cilit i është shkaktuar dëmtim fizik, mendor, apo cenimi i të drejtave dhe lirive të tij, sipas parimit të barazisë në sferën publike apo private të jetës;

1.7. viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, i cili është rrëmbyer, fshehur, transportuar apo i pranuar me dhunë me qëllim të eksploatimit, edhe nëse nuk është përdorur ndonjë nga mjetet e kërcënimit apo të përdorimit të forcës, detyrimit, mashtrimit, gënjimit apo formës së ngjashme pa marrë parasysh nëse fëmija e ka dhënë apo jo vullnetarisht apo nëpërmjet mashtrimit dhe lajthitjes pëlqimin e tij.

1.8. viktimë e keqpërdorimit të substancave narkotike, psiko - aktive dhe të formave tjera të varësisë, të cilat për shkak të varësisë, të ndikimeve negative sociale dhe të çrregullimeve e dëmton dhe rrezikon shëndetin dhe jetën e tij;

1.9. me shtetësi të Republikës së Kosovës dhe fëmija i huaj që është pa shoqërues të moshës madhore, të cilët para hyrjes në Republikën e Kosovës gjenden pa përcjellje të prindërve apo të kujdestarit ligjor, ose ai fëmijë i cili mbetet pa përcjellje të prindërve, pas hyrje në territorin e Republikës së Kosovës;

1.10. të cilit për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet formë përkatëse e përkujdesjes sociale për shkak të varfërisë, ikjes, refugjatë, gjendjes së luftës, vuajtjes së migrimit të detyrueshëm, vdekjes së një apo më shumë anëtarëve të familjes, kthimit nga shërimi, lirimi nga institucioni apo nga rrethanat e tjera të paparashikuara.

Neni 31

Personi madhor dhe i moshuar përfitues i shërbimeve sociale

1. Përfitues i shërbimeve sociale është personi madhor dhe personi i moshuar:

1.1. me aftësi të kufizuar mendore, intelektuale apo shqisore me dëmtime afatgjata, pa kujdes familjar;

1.2. i cili për shkak të paaftësisë për të gjykuar, është tërësisht ose pjesërisht i paaftë të kujdeset për të drejtat dhe interesat e tij;

1.3. që me veprimet e veta të ashpra i rrezikon të drejtat dhe interesat e tij ose të drejtat dhe interesat e personave të tjerë për shkak të sëmundjes së diagnostifikuar, paaftësisë për të gjykuar, ngecjes në zhvillimin psikik apo keqpërdorimit të alkoolit ose të mjeteve narkotike;

1.4. materialisht i pasiguruar, përkatësisht personi në gjendje të varfërisë i cili është kualifikuar për kompensimin minimal të garantuar;

1.5. i moshës mbi 65 vjeç pa përkujdesje familjare, i cili për shkak të ndryshimeve të përhershme në gjendjen psiko-sociale apo shëndetësore nuk mund t'i plotësojë nevojat themelore jetësore dhe i cili nuk ka anëtar të familjes as të afërm të cilët me ligj janë të detyruar të përkujdesen, apo për arsye të caktuara nuk kanë mundësi t'a kryejnë detyrimin e përkujdesjes;

1.6. me aftësi të kufizuar dhe i lënë pas dore;

1.7. me aftësi të kufizuar dhe i keqtrajtuar;

1.8. me aftësi të kufizuar dhe i pa shoqëruar si përgjatë migrimit, zhvendosjes si pasojë e luftërave dhe tërmeteve;

1.9. me aftësi të kufizuar të cilëve për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet formë përkatëse e kujdesit social;

1.10. me aftësi të kufizuar, i cili për shkak të ndryshimeve të përhershme në gjendjen psiko-sociale apo shëndetësore nuk mund t'i plotësojë nevojat themelore jetësore dhe i cili nuk ka anëtar të familjes as të afërm të cilët me ligj janë të detyruar të përkujdesen, apo për arsye të caktuara nuk kanë mundësi t'a kryejnë detyrimin e përkujdesjes;

1.11. me sjellje negative shoqërore i cili nuk orientohet nga puna, por drejt bredhjes, kërkimit të lëmshës, prostitucionit dhe formave tjera negative të sjelljes shoqërore;

1.12. viktimë e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore apo i formave tjera të dhunës të cilit i është shkaktuar dëmtim fizik, mendor, seksual apo ekonomik ose vuajtje, të cilat seriozisht e pengojnë personin që të gëzojë të drejtat dhe liritë e tij, sipas parimit të barazisë në sferën e jetës publike dhe private;

1.13. viktimë e trafikimit me njerëz, i cili është kidnapuar, fshehur, me dhunë është transportuar apo është marrë me anë të kërcënimit ose me përdorimin e forcës, apo me mashtrim dhe me forma tjera të detyrimit apo të mashtrimit.

1.14. viktimë e keqpërdorimit të mjeteve narkotike, psiko-aktive dhe të formave tjera të varësisë të cilat e kanë sjellë në gjendje të nevojës sociale.

1.15. i pastrehë, i cili nuk ka vendbanim as mjete me të cilat do të kishte mundësi të siguronte banimin, dhe përkohësisht është vendosur në vendin e caktuar për praninë ose qëndron në vendet publike apo në vendet e tjera të cilat nuk janë të destinuara për banim;

1.16. të cilit për shkak të rrethanave të veçanta i nevojitet formë përkatëse e përkujdesjes sociale për shkak të varfërisë, fatkeqësive elementare, ikjes, gjendjes së luftës, migrimit të përjetuar të detyrueshëm, vdekjes së njërit apo të më shumë anëtarëve të familjes, kthimit nga shërimi, lëshimi nga institucioni apo i rrethanave tjera të paparashikueshme.

KAPITULLI V

PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE PUBLIKE, PRIVATE DHE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE

Neni 32

Roli i Ministrisë

1. Harton dhe zbaton politikat për shërbime sociale dhe familjare si dhe mbrojtje për fëmijët.
2. Zhvillon ngritjen e burimeve njerëzore për profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare.

3. Licencon personat fizik dhe juridik, ofrues të shërbimeve sociale dhe është përgjegjëse për themelimin e institucioneve të kujdesit sociale e rezidencial për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.
4. Harton dhe është përgjegjëse për përgatitjen e standardeve minimale dhe Kodit Etik për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.
5. Inspekton dhe monitoron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga institucionet e sektorit publik, organizatat joqeveritare dhe ofruesit privat të licencuar.

Neni 33 **Roli i komunës**

1. Komuna përmes institucioneve të shërbimeve sociale dhe familjare ofron shërbime sociale dhe familjare.
2. Komuna zbaton standardet minimale dhe aktet tjera normative për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare të përcaktuara nga Ministria.
3. Ministria mund të marrë kompetencën e ofrimit të shërbimeve nga komuna, përveç atyre të cilat janë përcaktuar si kompetenca vetanake të komunës në Ligjin përkatës për Vetëqeverisje Lokale, në rast se dështojnë të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare cilësore.
4. Drejtoria përkatëse komunale mund t'u japë udhëzime për masat që duhet të ndërmarrin për harmonizimin e cilësisë së shërbimeve me standarde ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, të cilët dështojnë në plotësimin e standardeve të pranueshme për të kryer shërbimet.
5. Dështimi në përmbushjen e udhëzimeve nga paragrafi 4 i këtij neni, mund të rezultojë me ndalesën e ushtrimit të mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare nga ana e ofruesit.

Neni 34 **Organizatrat joqeveritare në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare**

1. Organizatat joqeveritare mund të ofrojnë shërbimeve sociale dhe familjare në pajtim me ligjin.
2. Organizatat joqeveritare të licencuara bashkëpunojnë në vazhdimësi me Ministrinë, Drejtorinë përkatëse komunale dhe Qendrat për Punë Sociale me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare.
3. Organizatat joqeveritare nga paragrafi 1 i këtij neni ofrojnë qasje në dokumentet dhe regjistrat e organizatës si dhe ofrojnë të dhënat për përfituesit e shërbimeve sociale dhe familjare sipas kërkesës së Ministrisë dhe Qendrës për Punë Sociale në pajtim me ligjin.

Neni 35
Bashkëpunimi i Ministrisë me subjektet e tjera

1. Ministria ofron propozime, sugjerime dhe këshilla për Qeverinë në lidhje me zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me shërbimet sociale dhe familjare.
2. Ministria bashkëpunon me komunat, njësitë akademike, ministritë e tjera dhe me palët e interesuara për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Neni 36
Këshilli Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare

1. Këshilli Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) licencën ofruesit individual për shërbime sociale dhe familjare, zhvillon programe për trajnimin e vazhdueshëm profesional për ofruesit e shërbimeve sociale, si dhe këshillon Ministrin në përcaktimin e prioritetëve të Ministrisë në fushën e shërbimeve sociale.
2. Kriteret dhe mënyra e licencimit të profesionistëve individual që ofrojnë shërbime sociale rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.
3. Këshillin e emëron Ministri, i cili përbëhet prej shtatë (7) anëtarë dhe zëvendësve të tyre. Anëtarët e Këshillit dhe zëvendës anëtarët emërohen për periudhën prej katër (4) vitesh.
4. Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Këshillit, Ministri i emëron nga radhët e: Ministrisë katër (4) anëtarë dhe zëvendës anëtar; univeriteti një (1) anëtar dhe një (1) zëvendës anëtar; organizatat joqeveritare të licencuara në fushën e shërbimeve sociale (1) anëtarë dhe një (1) zëvendës anëtar, qendrat për punë sociale një (1) anëtarë dhe një (1) zëvendës anëtar.
5. Këshilli vendosë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
6. Kryesuesin e Këshillit e zgjedhin anëtarët e Këshillit përmes votimit të fshehtë me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, në takimin e saj konstituiv.
7. Për kryerjen e punëve administrative - teknike për Këshillin, Ministria i cakton zyrtarët nga radhët e të punësuarve në Ministri.
8. Për punën në Këshill, kryetari dhe anëtarët kompensohen në pajtimin me ligjin përkatës në fuqi.
9. Ndaj vendimit të Këshillit mund të ngritet konflikt administrativ në gjykatën kompetente.
10. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

KAPITULLI VI KOMPETENCA DHE PROCEDURA

Neni 37 Kompetenca lëndore

1. Për realizimin e të drejtave nga shërbimet sociale dhe familjare të përcaktuara me ligj vendos Qendra për Punë Sociale.
2. Kundër vendimit të Qendrës për Punë Sociale, pala e pakënaqur mund të parashtrijë ankesë në Komisionin përkatës për ankesa, i cili përbëhet nga tre (3) anëtar, përfaqësues të departamenti përkatës për mirëqenie sociale në Ministri.
3. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.
4. Përveç nëse nuk parashihet ndryshe në këtë ligj, zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 38 Kompetenca territoriale

1. Për realizimin e të drejtave nga shërbimet sociale dhe familjare, kompetente është Qendra për Punë Sociale në territorin e të cilës pala e ka vendbanimin.
2. Në qoftë se pala nuk ka vendbanim të caktuar në territorin e Republikës së Kosovës, kompetenca territoriale caktohet sipas vendqëndrimit të palës.
3. Nëse nuk mund të përcaktohet vendbanimi ose vendqëndrimi i palës, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Kompetenca territoriale e Qendrës për Punë Sociale për rastin e fëmijës caktohet sipas vendbanimit, përkatësisht të vendqëndrimit të prindërve.
5. Për fëmijën, prindërit e të cilit jetojnë ndaras, kompetenca territoriale e Qendrës për Punë Sociale caktohet sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të prindit të cilit i është besuar fëmija me vendim të gjykatës.
6. Deri në nxjerrjen e vendimit nga paragrafi 5 i këtij neni, kompetencë territoriale ka Qendra për Punë Sociale sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të prindit tek i cili jeton fëmija.
7. Nëse prindërve të cilët jetojnë ndaras u është marrë e drejta në ruajtje dhe kujdes të fëmijës, apo fëmija i është besuar në ruajtje dhe përkujdesje personit tjetër apo shtëpisë së shërbimit social për fëmijën, kompetente është Qendra për Punë Sociale sipas vendbanimit, apo vendqëndrimit të prindërve para ndarjes së tyre.
8. Kompetenca territoriale e Qendrës për Punë Sociale për fëmijën nuk ndryshohet nëse prindërve iu është marrë e drejta prindërore, përveç në rastin e adoptimit.

9. Qendra për Punë Sociale e cila e ka filluar procedurën është e obliguar, që nëse gjatë procedurës ndryshohen rrethanat sipas të cilave caktohet kompetenca territoriale, që shkresat e lëndës, pa vonesë, jo më larg se shtatë (7) ditë, t'ia dërgojë Qendrës kompetente për Punë Sociale.

10. Në qoftë se përfituesi e ndryshon vendbanimin apo vendqëndrimin, Qendra për Punë Sociale është e obliguar që, pa vonesë, jo më larg se shtatë (7) ditë, t'ia dërgojë shkresat e lëndës Qendrës për Punë Sociale kompetente sipas vendbanimit apo vendqëndrimit të përfituesit, e cila vendos për të drejtën e shfrytëzimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dërgimit të shkresave.

11. Në rastet kur përfituesi nga paragrafi 10 i këtij neni ndryshon vendbanim apo vendqëndrimin duke lëvizur jashtë territorit të Kosovës, Qendra për Punë Sociale inicion bashkëpunim ndërshtetëror përmes mekanizmave përgjegjës të vendit.

12. Paraqitësi i kërkesës ose personi i cili është gjetur në pozitën e rrezikut social jashtë territorit të vendbanimit të tij, Qendra për Punë Sociale kompetente për atë territor i sigurojë të drejtën përkatëse të mbrojtjes sociale.

13. Paraqitësi i kërkesës, i cili nuk ka vendbanim në territorin e Kosovës, kompetenca territoriale përcaktohet sipas vendqëndrimit.

14. Për paraqitësin e kërkesës me vend të panjohur të jetesës, kompetent është Qendra për Punë Sociale në territorin në të cilin është paraqitur kërkesa apo është gjetur personi.

Neni 39

Konflikti për kompetencë dhe përjashtimi

1. Për konfliktin e kompetencës territoriale ndërmjet Qendrave për Punë Sociale vendos Ministria.

2. Nëse paraqitet konflikti për kompetencën territoriale, Qendra për Punë Sociale e cila e ka filluar e para procedurën, duhet të kryejë veprimet në procedurë të cilat nuk mund të shtyhen.

3. Për përjashtimin e zyrtarit nga menaxhimi i rastit të Qendrës për Punë Sociale vendos Drejtori i Qendrës për Punë Sociale.

4. Për përjashtimin e drejtorit të Qendrës për Punë Sociale vendos organi kompetent i komunës për punët e shërbimeve sociale.

5. Në rast të përjashtimit të Drejtorit apo të përjashtimit të njëkohshëm të drejtorit dhe të zyrtarit profesional, dhe Qendra për Punë Sociale nuk mundet kryejë detyrat dhe përgjegjësitë, Ministria pas konsultimit dhe njoftimit paraprak me komunën përkatëse, e cakton Qendrën tjetër për Punë Sociale për rastin.

Neni 40 Procedura

1. Procedura për realizimin e të drejtave të përcaktuara sipas këtij ligji inicohet sipas kërkesës së personit apo prindërit, adoptuesit, kujdestarit, përfituesit dhe personave fizik dhe juridik dhe sipas detyrës zyrtare.
2. Qendra për Punë Sociale zhvillon procedurën sipas detyrës zyrtare kur kjo është në interes të përfituesit, interesin publik apo kur ekziston interesi i personave të tretë.
3. Kërkesa për realizimin e të drejtave nga paragrafi 1 i këtij neni paraqitet në formularin të cilin e përcakton organi kompetent.

Neni 41 Përgjegjësia e paraqitësit të kërkesës për vërtetësinë e të dhënave në kërkesë

1. Paraqitësi i kërkesës është përgjegjës për vërtetësinë e të dhënave në kërkesë.
2. Paraqitësi i kërkesës, përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor, kujdestari apo i autorizuari i tij është i obliguar që ta informojë Qendrën kompetente për Punë Sociale për çdo ndryshim të fakteve apo të rrethanave të cilat vlejné për shfrytëzimin e të drejtës dhe kanë qenë bazike për njohjen e të drejtës së shërbimit social, më së voni në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur janë paraqitur ato ndryshime.
3. Nëse paraqitësi i kërkesës, përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor apo kujdestari nuk vepron në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, i pushon e drejta në përfaqësim.

Neni 42 Ndihma profesionale

1. Para se të vendosë për të drejtat e shërbimeve sociale, Qendra për Punë Sociale, i jep personit ndihmë profesionale me rastin e paraqitjes së kërkesës, e udhëzon dhe ndihmon për realizimin e të drejtave.
2. Qendra për Punë Sociale e përcakton nevojën për realizimin e të drejtave në shfrytëzimin e shërbimeve sociale në bazë të vizitës vlerësuese të drejtpërdrejtë të kryer në shtëpinë apo banesën e përfituesit.
3. Qendra për Punë Sociale për përfituesin e të drejtës së shërbimit social konstaton nevojën në bazë të vlerësimit të kryer pas vizitës së drejtpërdrejtë në shtëpinë apo banesën e përfituesit, në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 43

Vendosja për kërkesën e përfituesit

1. Me rastin e vendosjes së kërkesës së përfituesit për pranimin e të drejtës nga ky Ligj, Qendra për Punë Sociale është e obliguar që të vlerësojë gjendjen e përgjithshme të rrezikut social dhe nevojat e individit në familje, dhe mund të përcaktojë të drejta të tjera me të cilat në mënyrë të përshtatshme plotësohen nevojat e përfituesit dhe nxjerr vendim.
2. Qendra për Punë Sociale është e obliguar që në procedurën e realizimit të të drejtës nga shërbimet sociale dhe familjare të hartojë planin individual dhe planin e aktiviteteve në trajtim, dhe të përcaktojë qëllimin që synohet të arrihet, të ndërmerren aktivitete të nevojshme që personi në gjendje nevoje të aftësohet për përkujdesje për vetveten dhe të anëtarëve të familjes.
3. Procedura për realizimin e të drejtës nga shërbimet sociale dhe familjare është urgjente, dhe në këtë rast Qendra për Punë Sociale duhet të nxjerrë vendimin për kërkesën në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.
4. Nëse nevojitet që të kryhet procedurë e veçantë e vlerësimit, Qendra është e obliguar që vendimin ta nxjerrë në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës së rregullt, përkatësisht të zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare.
5. Në rastet urgjente siç është ndërmarrja e masave me qëllim të evitimit të rrezikut të drejtpërdrejtë të nevojave themelore jetësore për jetën dhe shëndetin e individëve, në veçanti të fëmijës, Qendra për Punë Sociale ndërmerr veprime për ofrimin e menjëhershëm të shërbimit përkatës në pajtim me ligjin.
6. Në rastin nga paragrafi 5 i këtij neni, vendimi për ofrimin e shërbimit të menjëhershëm nxirret në formën e shkruar në afat prej tetë (8) ditësh.

Neni 44

Kontraktimi i drejtpërdrejtë i shfrytëzimit të shërbimeve

1. Përfituesi apo përfaqësuesi i tij ligjor, kujdestari apo personi përgjegjës sipas ligjit, mundet drejtpërdrejt të zgjedhë ofruesin e shërbimeve dhe të lidhë kontratë për shfrytëzimin e shërbimeve, nëse bartë në tërësi koston e shpenzimeve të ofruesit të shërbimeve.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk mund të zgjedhën ofruesit e shërbimeve për strehim:
 - 2.1. të fëmijës në strehim rezidencial;
 - 2.2. të personit të privuar nga zotësia e veprimit.
3. Shërbimet nga paragrafi 2 i këtij neni shfrytëzohen në bazë të vendimit të Qendrës për Punë Sociale, apo të vendimit të gjykatës në pajtim me ligjin.

Neni 45

Ekspertiza

1. Nëse në procedurën e realizimit të të drejtës nga shërbimet sociale dhe familjare duhet vlerësuar aftësitë punuese, përkatësisht ekzistimi i ndryshimeve të përhershme apo të përkohshme në gjendjen shëndetësore dhe llojin e shkallës së dëmtimit fizik, mendor, intelektual apo shqisor afatgjatë, Qendra për Punë Sociale mund të kërkojë ekspertizë nga organet kompetente.
2. Në rast se pala është pakënaqur me vendimin e Qendrës për Punë Sociale, ka të drejtën e ankese në Komisionin përkatës për ankese në Ministri në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
3. Komisioni nga paragrafi 2 i këtij me rastin e shqyrtimit të ankesës dhe sipas nevojës mund të kërkojë ekspertizë përkatëse nga organet kompetente.

Neni 46

Ofrimi i të dhënave

Përfituesi është i obliguar që të japë të dhëna personale të sakta, të dhëna për të hyrat e tij dhe gjendjen pasurore, si dhe për rrethanat e tjera nga të cilat varet pranimi i të drejtave nga shërbimi social dhe familjar.

Neni 47

Rishqyrtimi i të drejtës dhe shërbimeve

Qendra për Punë Sociale rishqyrton së paku një herë në vit ekzistimin e fakteve dhe të rrethanave për njohjen e të drejtës për realizimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe vlerësimin e rrethanave të reja nga të cilat varet realizimi i të drejtës dhe i shërbimeve.

KAPITULLI VII

INSTITUCIONET E SHËRBIMEVE SOCIALE

Neni 48

Themelimi

1. Institucioni i shërbimit social themelohet nga Ministria, komuna apo personi tjetër fizik e juridik në pajtim me ligjin.
2. Nëse institucionin e themelojnë disa subjekte nga paragrafi 1 i këtij neni, marrëdhëniet reciproke për të drejtat dhe detyrimet e themeluesve rregullohen me kontratë apo marrëveshje.
3. Institucioni i shërbimit social, themelues i të cilit është organi qendror apo komunal, themelohet si institucion publik.

4. Themeluesi i institucionit publik në pronësi të Republikës së Kosovës, është Qeveria.
5. Themeluesi i institucionit publik në pronësi të komunës është Kuvendi i Komunës.
6. Statuti është akti i përgjithshëm themelor i institucionit publik.
7. Institucioni i shërbimit social mund të nxjerrë edhe aktet e tjera të përgjithshme me të cilat rregullohen marrëdhëniet e brendshme, organizimi i punës, shërbimet që ofron dhe çështjet e tjera me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë.

Neni 49

Kushtet për themelimin e institucioneve të shërbimeve sociale

1. Institucioni i shërbimit social mund të themelohet nëse i plotëson kushtet në pikëpamje të hapësirës, infrastrukturës, pajisjeve, dhe numrit të nevojshëm të punëtorëve profesionalë dhe të tjerë, varësisht nga lloji i veprimtarisë të cilën e kryen institucioni në pajtim me këtë ligj.
2. Kushtet minimale për themelimin e institucioneve të shërbimeve sociale përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 50

Greva në institucionet e shërbimeve sociale

1. Nëse në institucionin e shërbimeve sociale organizohet grevë, varësisht prej veprimtarisë duhet të sigurohet se do të ofrohen shërbimet përkatëse sociale, në mënyrë të papengueshme dhe të vazhdueshme, duke përfshirë në veçanti kryerjen e këtyre punëve:

- 1.1. pagesa e rregullt e pranimeve në të holla nga përfituesit;
- 1.2. strehimi, ushqimi dhe mbrojtja shëndetësore e përfituesve të vendosur në institucionet e shërbimeve sociale;
- 1.3. ndihma dhe përkujdesja në shtëpi;
- 1.4. shërbimet që nga natyra e tij nuk mund të shtyhen.

Neni 51

Regjistrimi i institucioneve

1. Institucionet e shërbimeve sociale dhe familjare regjistrohen si:
 - 1.1. Qendra për Punë Sociale;
 - 1.2. Këshillimore familjare;
 - 1.3. Institucioni i shërbimeve sociale për strehim dhe përkujdesje;

1.4. Qendra për mbështetje dhe përkujdesjeje;

1.5. Shtëpi të sigurta;

1.6. Institucioni për kujdesin social për plotësimin e nevojave dhe shërbimeve ditore;

1.7. Qendra për pranim për raste emergjente.

2. Llojet e institucioneve nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zgjerohet në pajtim me nevojat e Ministrisë apo komunës.

3. Nëse fushëveprimi i institucionit nga paragrafi 1 i këtij neni bie në kompetencë të të dy apo më shumë ministrive, marrëdhëniet reciproke të të drejtave dhe detyrave të ministrive, do të rregullohen me marrëveshje të posaçme.

Neni 52 **Qendra për Punë Sociale**

1. Qendra për Punë Sociale është institucion publik administrativ dhe profesional komunal, e cila themelohet nga komuna pas dhënies së pëlqimit nga Ministria.

2. Secila komunë themelon Qendrën për Punë Sociale.

3. Qendra për Punë Sociale mund të ketë një apo më shumë njësi organizative brenda një komune.

4. Në kuadër të Qendrës për Punë Sociale themelohet Organi i Kujdestarisë, i cili funksion si grup i profesionistëve në përputhje me ligjin, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve.

5. Qendra për Punë Sociale menaxhohet nga drejtori i Qendrës.

6. Qendra për Punë Sociale nxjerrë statutin e saj në pajtim me ligjin.

7. Organizimi, përgjegjësitë, lloji dhe numri i profesionistëve si dhe funksionimi i Qendrës për Punë Sociale rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.

Neni 53 **Kompetencat e Qendrës për Punë Sociale**

1. Qendra për Punë Sociale:

1.1. vendos në shkallë të parë për autorizimet themelore dhe të zgjeruara nga shërbimet sociale;

1.2. zbaton vendimet gjyqësore;

- 1.3. organizon dhe ofron drejtpërdrejtë shërbimet sociale;
- 1.4. vlerëson nevojat e përfituesve dhe planifikon ofrimin e shërbimeve.
- 1.5. inicion dhe organizon aktivitete parandaluese për fushën e shërbimeve sociale;
- 1.6. identifikon në fazë të hershme, përcjell dhe analizon problemet e përfituesve nga fusha e shërbimeve sociale;
- 1.7. zbaton aktivitete në fushën e parandalimit të trafikimit me njerëz, të dhunës në familje, të dhunës së bashkëmoshatarëve dhe të problemit të varësisë;
- 1.8. lëshon dëshmi, vërtetim, konstatim mbi bazën e vlerësimit të gjendjes faktike të personit apo familjes;
- 1.9. jep mendime dhe vlerësime profesionale, ofron të dhëna për rrethanat familjare, propozime dhe rekomandime në procedura gjyqësore lidhur me mbrojtjen familjare juridike;
- 1.10. zbaton metodat e punës sociale, menaxhimin e rastit, metodat e tjera profesionale dhe shfrytëzon shërbimet e këshillimoreve dhe institucioneve tjera profesionale për ofrimin e shërbimeve sociale për përfituesit;
- 1.11. merr pjesë si palë përfaqësuese në gjykatës dhe organeve tjera shtetërore kur bëhet fjalë për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, të cilët nuk mund të kujdesen vetë për vetën për të drejtat dhe interesat e tyre;
- 1.12. kryen mbikëqyrjen ndaj familjeve strehuese dhe për përfituesit e shërbimeve në strehim familjar dhe në strehim rezidencial.
- 1.13. mban evidencën dhe dokumentacionin për të drejtat, për shërbimet e ofruara dhe masat e ndërmarra në kuadër të veprimtarisë së vet;
- 1.14. kryen edhe punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

2. Qendra për Punë Sociale në bazë të autorizimeve publike mund të sigurojë masa të mbrojtjes përmes formave alternative të përkujdesjes për fëmijën e ikur apo larguar nga prindërit apo institucioni, siguron dhe zbaton masat edukuese ndaj fëmijës me ç'rregullime në sjellje jashtë familjes së tij apo me qëndrim në familje.

Neni 54 **Këshillimorja familjare**

1. Këshillimorja familjare është shërbim social që ofron shërbime sociale dhe familjare të këshillimit të cilën mund ta themelojë personi juridik dhe fizik, ndërsa mund të themelohet edhe si njësi në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.
2. Në territorin e komunës mund të ketë një apo më shumë këshillimore familjare.

3. Këshillimorja familjare ofron shërbime në fushën psiko-sociale për familjet, me fokus të veçantë në ngritjen dhe forcimin e marrëdhënieve familjare.
4. Këshillimorja bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe akterët relevant në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

Neni 55 **Kompetencat e këshillimores familjare**

1. Këshillimorja familjare ofron këshillim në parandalim dhe punë tjera profesionale lidhur me:
 - 1.1. punën individuale, familjare dhe punën grupore këshilluese-terapeutike;
 - 1.2. punën edukative me përfituesit e shërbimeve dhe të punësuarve në sistemin psiko-social;
 - 1.3. ndihmës profesionale institucioneve dhe organizatave në pajtim me nevojat e tyre;
 - 1.4. promovimin e marrëdhënieve familjare të shëndetshme të jetës.
2. Këshillimorja familjare kryen edhe punë analitike profesionale nga fushëveprimi i saj.

Neni 56 **Shtëpia me Bazë në Komunitet**

1. Shtëpia me Bazë në Komunitet themelohet nga Ministria, komuna, personi juridik apo fizik;
2. Shtëpia me Bazë në Komunitet themelohet për kryerjen e shërbimeve sociale jashtë familjes, dhe ato janë:
 - 2.1. Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë:
 - 2.1.1. Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë pa përkujdesje prindërore apo pa përkujdesje familjare;
 - 2.1.2. Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë me aftësi të kufizuara pa përkujdesje familjare;
 - 2.1.3. Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë me sjellje asociale;
 - 2.2. Shtëpi me Bazë në Komunitet për persona të rritur;
 - 2.3. Shtëpi me Bazë në Komunitet për persona të moshuar pa përkujdesje familjare;
 - 2.4. Shtëpi me Bazë në Komunitet për persona me aftësi të kufizuara pa përkujdesje familjare.

Neni 57
Shtëpia me Bazë në Komunitet për fëmijë

1. Shtëpia me Bazë në Komunitet për fëmijë themelohet, si:

1.1. Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë pa përkujdes prindëror, i cili ofron shërbime sociale jashtë familjes së tij, për fëmijë pa prindër apo prindërit të cilët nuk kujdesen apo keqpërdorin detyrat e tyre prindërore, apo nga arsye tjera është në interes të fëmijës apo të personit madhor të ri;

1.2. Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë me aftësi të kufizuar pa kujdes prindëror, e cila fëmijës me aftësi të kufizuar i siguron strehim, ushqim, veshmbathje, aktivitete rekreative dhe kulturore-zbavitëse, terapi punuese, ndërsa në pajtim me aftësitë e tyre, llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar ofron mbështetje në arsimim dhe aftësim;

1.3. Shtëpi me Bazë në Komunitet për fëmijë me sjellje asociale e cila plotëson nevojat e fëmijëve në bazë të masës së shqiptuar të mbrojtjes familjare-juridike, mësimin e fëmijës në institucionin për ruajtje dhe edukim, apo për strehimin dhe ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes jashtë familjes së tij dhe shërbimeve të arsimimit të fëmijëve dhe të personave madhorë të rinj me sjellje asociale.

Neni 58
Shtëpia me Bazë në Komunitet për persona të rritur dhe të moshuar

1. Shtëpia me Bazë në Komunitet për persona të rritur dhe të moshuar themelohet, si:

1.1. Institucion për persona të moshuar pa përkujdesje familjare, i cili ofron shërbime të mbrojtjes jashtë familjes për personin e paaftë të cilit për shkak të ndryshimeve të përhershme në gjendjen shëndetësore dhe për shkak të paaftësisë, vlerësohet se është e nevojshme mbështetja dhe përkujdesja e përhershme.

1.2. Institucioni për persona me paaftësi intelektuale, i cili i ofron shërbime të mbrojtjes jashtë familjes së tij, personit të cilit mbrojtja nuk mund t'i ofrohet në familjen e tij apo të sigurohet në mënyrë tjetër.

Neni 59
Ofruesit e shërbimeve për mbështetje dhe përkujdesje në shtëpi

1. Të moshuarit, personit të pafuqishëm dhe personit me aftësi të kufizuar, i ofrohen shërbime për mbështetje dhe përkujdesje dhe i sigurohet kryerja e punëve të domosdoshme shtëpiake dhe përkujdesi në shtëpinë e tyre.

2. Fëmijës me aftësi të kufizuar dhe fëmijës me sëmundje kronike të rënda, i ofrohen shërbime dhe mbështetje dhe i sigurohet kujdes në shtëpitë e tyre.

3. Shërbimet për mbështetje dhe përkujdesje në shtëpi, mund të themelohen nga institucionet e shërbimeve sociale, organizatat joqeveritare apo personat vendor dhe të huaj fizik dhe juridik në pajtim me ligjin.

Neni 60 **Strehimoret**

1. Ministria, komuna, organizatat joqeveritare dhe personat fizik e juridik mund të themelojnë strehimore me qëllim të sigurimit të strehimit, mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimeve të përkohshme për fëmijën pa kujdes prindëror, viktimën e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, apo edhe ndonjë formë tjetër të dhunës dhe mbrojtjes të përcaktuar me legjislacion
2. Komuna, organizata joqeveritare, personat fizik apo juridik nuk mund të themelojë strehimore për njerëzit në nevojë sociale pa lejen e Ministrisë.
3. Strehimoret ofrojnë strehim të sigurtë, shërbime për mbrojtjen, rehabilitimin, riintegrimin dhe ofrimin e mbështetjes së specializuar për viktimën e dhunës nga paragrafi 1 i këtij neni, duke ua përshtatur nevojave të tyre specifike.
4. Shërbimet e specializuara përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këshillimin psikologjik, kujdesin shëndetësor dhe këshillim juridik.
5. Strehimoret bashkëpunojnë me institucionet nga sistemi social, psiko-social, arsimit dhe shëndetësisë, policisë, prokurorisë dhe gjykatave.
6. Puna në strehimore realizohet sipas parimit të urgjencës dhe vendosjes së përkohshme.
7. Të gjitha masat duhet të ndërmerren që viktimat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni të kthehen në familjet e tyre apo në forma të tjera të mbrojtjes, në përputhje me interesin më të mirë të viktimës, duke iu siguruar një riintegrim të sigurtë dhe të qëndrueshëm.
8. Në procedurën e strehimit, puna dhe masat e tjera në strehimore përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.
9. Themelimi, organizimi dhe funksionimi i Shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve përcaktohen me Ligjin përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 61 **Qendrat e Kujdesit Ditor**

1. Për përkujdesin ditor dhe shërbime ditore në komunitet themelohen Qendrat e Kujdesit Ditor.
2. Qendrën e Kujdesit Ditor nga paragrafi 1 të këtij neni, mund ta themelojë Ministria, komuna, organizatat joqeveritare, personi fizik apo juridik në pajtim me ligjin.
3. Qendrat e Kujdesit Ditor për përkujdesjen ditore dhe shërbime sociale, janë:
 - 3.1. Qendra e Kujdesit Ditor për fëmijë;
 - 3.2. Qendra e Kujdesit Ditor për të rritur dhe të moshuar;
 - 3.3. Qendra për shërbime sociale të specializuara.

4. Organizimi dhe fushëveprimi i Qendrave për Kujdes ditor rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.

Neni 62 **Qendra për pranim**

1. Për përkujdesje për periudhë të shkurtër për fëmijët e braktisur, fëmijët me ç'rregullime në sjellje, personat e rritur me sjellje shoqërore negative, shtatzënat dhe nënat me fëmijë deri në një vit të jetës së fëmijës, të cilëve për shkak të pasigurisë materiale, të çështjes banesore të pazgjidhur, të marrëdhënieve familjare të çrregulluara, dhe të situatave të ngjashme, nevojitet përkujdesi i përkohshëm, si dhe personat e tjerë të cilët kanë nevojë për përkujdesje sociale urgjente, Ministria themelon Qendrën për pranim.

2. Selia e Qendrës për Pranim është në Prishtinë.

3. Në qendrën për pranim kryhet trajtimi diagnostiko-observator, si dhe ofrimi i masave të domosdoshme të mbrojtjes, si dhe aplikimi i masave shëndetësore-higjienike, edukativo-arsimore dhe masat psiko-sociale për plotësimin e nevojave ekzistenciale dhe të nevojave tjera të shfrytëzuesve.

4. Qëndrimi në qendrën pranuese mund të zgjasë deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, ndërsa vetëm në situatat e veçanta mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë, nëse procedura e gjetjes së formës adekuate të përkujdesjes e kërkon këtë.

5. Organizimi dhe fushëveprimi i Qendrës për Pranim rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.

Neni 63 **Strehimi në institucion e përkujdesjes**

1. Pranimi i personit në institucion dhe lëshimi i tyre kryhet në mënyrën e caktuar me aktin e përgjithshëm të institucionit dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria.

2. Institucioni është i obliguar të pranojë në strehim personat të cilët i dërgon qendra për punë sociale apo organi tjetër kompetent.

3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 të këtij neni, institucioni mund të refuzojë pranimin e personave të dërguar në rast se kapacitetet plotësohen dhe në rastin kur për shkak të veprimtarisë së saj, nuk ka mundësi që të ofrojë shërbime përkatëse të përfituesve,

4. Në rast të refuzimit, Institucioni i Përkujdesjes ofron përgjigje të arsyetuar me shkrim.

5. Institucioni i përkujdesjes në të cilin është vendos fëmija, personi i rritur dhe i moshuar me vendim të Organit të Kujdestarisë, e informon Organin e Kujdestarisë për të gjitha çështjet e rëndësishme për jetën, shëndetin, edukimin, arsimimin e personit nën përkujdesje, dhe lëshimin e mundshëm nga institucioni.

6. Për strehim në të gjitha format e strehimit rezidencial vendos Qendra për Punë Sociale në territorin e të cilës personi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

7. Qendra për Punë Sociale e cila e ka vendosur personin në cilëndo formë të përkujdesjes, kërkon raport dhe përcjellë ofrimin e përkujdesjes në strehim rezidencial.

Neni 64

Pushimi i veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve për strehim rezidencial

Themeluesit e shërbimeve për strehim janë të obliguar që së paku gjashtë muaj para nxjerrjes së vendimit për pushimin e veprimtarisë së shërbimit, ta njoftojnë Qendrën për Punë Sociale, Ministrinë si dhe përfituesit, përkatësisht përfaqësuesit e tyre ligjor.

KAPITULLI VIII

PUNONJËSI PROFESIONAL NË SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

Neni 65

Punonjësit profesional në institucionin e shërbimit social dhe ofruesit e shërbimeve sociale

1. Në institucionet e shërbimeve sociale, përkatësisht tek ofruesi i shërbimit social, punët profesionale i kryen punonjësi social, juristi, psikologu, sociologu, pedagogu dhe personat e tjerë në pajtim me ligjin.

2. Profesionistët nga paragrafi 1 i këtij neni kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive, të pavarur, të paanshme dhe duhet t'u përmbahen parimeve të fshehtësisë profesionale lidhur me informatat e mbledhura, të gjeturat tjera për të cilat mësojnë gjatë kryerjes së detyrës dhe praktikave jo diskriminuese, në pajtim kodin e etikës me ligjin dhe aktet nënligjore përkatëse.

3. Punët profesionale në shërbimin social në Qendrën për Punë Sociale i kryejnë punonjësi social, juristi, psikologu, sociologu dhe pedagogu.

4. Punonjësit profesional në institucionet e tjera të shërbimeve dhe tek ofruesit e tjerë të shërbimeve sociale, punët profesionale i kryen përveç punonjësve nga paragrafi 3 i këtij neni i kryejnë edhe logopedi, infermierja, fizioterapeuti dhe edukatori, ndërsa mund t'i kryejnë edhe punëtorët e tjerë profesional të arsimimit përkatës, varësisht nga institucioni për shërbime sociale apo lloji tjetër i shërbimeve sociale të ofruesit tjetër.

5. Punonjësit profesional janë të obliguar që të ruajnë si fshehtësi të gjitha njohuritë për jetën personale dhe familjare të përfituesit, ndërsa ruajtja e fshehtësisë profesionale i obligon edhe punëtorët e tjerë të institucioneve të shërbimeve sociale dhe të ofruesve tjerë të shërbimeve.

6. Mosrespektimi i konfidencialitetit nga zyrtari përgjegjës dhe çdo personi tjetër i cili pranon raportime në interes publik do të konsiderohet si shkelje e detyrave të punës.

7. Shërbimet sociale dhe familjare për të mirën e komunitetit mund të ofrohen edhe vullnetarët.

8. Ministri nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e shërbime sociale dhe familjare të cilat i ofrojnë vullnetarët.

Neni 66
Përpunimi i të dhënave personale

Çdo përpunim i të dhënave personale, përfshirë shkëmbimin ose transmetimin e të dhënave personale nga ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, do të bëhet në pajtim me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 67
Aftësimi profesional i punonjësve të shërbimeve sociale

1. Punonjësit profesional në fushën e shërbimit social kanë të drejtë dhe detyrim që të vijnë në mënyrë të vazhdueshme aftësimin profesional.
2. Institucioni i shërbimit social, përkatësisht ofruesi i shërbimeve sociale është i obliguar që punonjësit profesional t'i sigurojë aftësimin profesional në pajtim me ligjin.

KAPITULLI IX
LICENCIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Neni 68
Licencimi

1. Institucione publike, si dhe organizatat joqeveritare dhe personat fizik e juridike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare licencohen nga Ministria.
2. Licenca nga paragrafi 1, i këtij neni i lëshohet ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare në kohëzgjatje prej tri (3) vite me mundësi të rilicencimit çdo pesë (5) vite.

Neni 69
Kushtet për dhënien e licencës

1. Të drejtën në licencë e ka institucioni, përkatësisht ofruesi i shërbimit i cili:
 - 1.1. është regjistruar në pajtim me ligjin;
 - 1.2. i plotëson kushtet e parapara në pikëpamje të hapësirës, infrastrukturës, pajisjeve dhe kuadrit profesional; dhe
 - 1.3. i plotëson standardet minimale të parapara për ofrimin e shërbimeve sociale për të cilën kërkon dhënien e licencës.
2. Rilicencimi mund të përsëritet sipas kërkesës së institucionit dhe ofruesit të shërbimit.

3. Për përsëritjen e licencës vlejné kushtet të cilat aplikohen në kohën e paraqitjes së kërkesës për përsëritje. Procedura për përsëritjen e licencës duhet të zhvillohet më së voni tre (3) muaj para skadimit të afatit për të cilën është dhënë licenca.

4. Nëse organi kompetent gjatë periudhës për të cilën është dhënë licenca, konstaton se institucioni apo ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare tanimë nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, do të zhvillojë procedurën për pezullimin e licencës.

5. Me vendimin për pezullim konstatohen mangësitë në pikëpamje të plotësimit të kushteve sipas paragrafit 1 të këtij neni përcaktohet afati për evitimin e tyre.

6. Institucioni dhe ofruesi i shërbimit social dhe familjar nuk mund të vazhdojë të ofrojë shërbime për të cilën është pezulluar licenca deri në skadimin e afatit për eliminimin e mangësive.

7. Ministri merr vendim për marrjen e licencës së institucionit apo ofruesit të shërbimeve sociale dhe familjare nëse në afatin e përcaktuar nga njësia inspektuese në Ministri nuk i eliminon mangësitë e konstatuara.

8. Vendimi i Ministrisë për marrjen e licencës është përfundimtar dhe kundër tij mund të iniciohet konflikti administrativ.

9. Procedura për dhënien, përsëritjen, pezullimin dhe marrjen e licencës përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 70

Licencimi i punonjësve profesional për marrjen e licencës

1. Punonjësi profesional mund të pajiset me licencë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare nëse i plotëson kriteret dhe kushtet e përcaktuara.

2. Kriteret dhe kushtet për marrjen e licencës për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga punonjësit profesional përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

KAPITULLI X MBIKËQYRJA

Neni 71

Mbikëqyrja e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare

1. Ministria nëpërmjet zyrtarëve të Departamentit përkatës, si dhe Komuna nëpërmjet Qendrës për Punë Sociale, mbikëqyrë ofrimin e shërbimeve social dhe familjare.

2. Për mbikëqyrjen nga paragrafi 1 i këtij neni përpilohet procesverbal.

3. Ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare bashkëpunojnë me zyrtarët mbikëqyrës dhe ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme.
4. Zyrtari mbikëqyrës jep udhëzime për masat që duhet të ndërmarrin për harmonizimin e cilësisë së shërbimeve me standarde profesionale.

Neni 72 Inspektimi

1. Ministria përmes inspektorëve kryen inspektimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare.
2. Njësia e inspektimit kryen:
 - 2.1. Inspektimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare të përcaktuara me ligj.
 - 2.2. Inspektimin e zbatimit të standardeve minimale në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.
 - 2.3. Inspektimin e zbatimit të kodit të etikës.
 - 2.4. Inspektimin për realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligj;
 - 2.5. Mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve dhe masave të shqiptuara.
 - 2.6. rekomandon marrjen e përgjegjësitë së drejtpërdrejta të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur komuna dështon në ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e standardeve minimale.
 - 2.7. rekomandon marrjen e licencës për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur personi fizik, personi juridik apo organizata joqeveritare dështon në ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e standardeve minimale.
3. Në kuadër të kryerjes së inspektimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, personi i autorizuar zyrtari i Ministrisë, mund të urdhëroj masa për mënjanimin e të metave në punën ofruesve të shërbimeve, dhe të caktoj afatin për të vepruar sipas atyre masave.
4. Mënyra e inspektimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 73 Njoftimi

1. Nëse gjatë inspektimit konstatohen shkelje nga institucionet dhe ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare gjatë ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, inspektori menjëherë e informon Ministrin dhe Kryetarin e Komunës më të gjeturat dhe i rekomandon Ministrin për ndërmarrjen e masave në pajtim me ligjin.

2. Ministri bazuar në raportin e inspektimit, merr vendim për:

2.1. marrjen e përgjegjësive të drejtpërdrejta të shërbimeve sociale dhe familjare në rastet kur komuna dështon në ofrimin e shërbimeve.

2.2. ndalimin e punës për ofruesit e shërbimeve sociale jo publike.

2.3. ndalimin e punës për ofruesit individual të shërbimeve sociale dhe familjare.

3. Në rast të ndalimit të punës për ofruesit e shërbimeve sociale jopublike dhe për ofruesit individual të shërbimeve sociale dhe familjare nga paragrafi 2 i këtij neni, Ministria e obligon Komunën dhe Qendrën për Punë Sociale përkatëse për gjetjen e mbrojtjes alternative për përfituesit e shërbimeve.

KAPITULLI XI

FINANCIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Neni 74 **Financimi**

1. Shërbimet sociale dhe familjare financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Shërbimet sociale dhe familjare mund të mbështeten nga partnerët zhvillimor nëpërmjet partneritetit publiko-privat dhe vetë pjesëmarrja e përfituesit të shërbimeve sociale dhe familjare.

3. Ministria planifikon buxhetin dhe siguron mjete për pagesë apo kompensime materiale për shërbime sociale dhe familjare të parapara me këtë ligj, por pa u kufizuar në:

3.1. familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;

3.2. shërbimet e strehimit rezidencial

3.3. shërbimet mbështetëse për të rinjtë për jetë të pavarur të mbikëqyrur;

3.4. qëndrimi ditor;

3.5. ndihma në shtëpi;

3.6. shërbimet e kuzhinës popullore;

3.7. pushim dhe rekreacion;

3.8. banim me mbështetje;

3.9. strehimi në qendrën për pranim – strehim;

3.10. banimi për personat të rrezikuar, në pajtim me ligjin; dhe

3.11. shërbime tjera në pajtim me mundësitë buxhetore.

4. Komunitet planifikojnë dhe sigurojnë buxhet për shërbime sociale dhe mjete financiare për pagesë, apo kompensime materiale të parapara me Ligj, por pa u kufizuar:

4.1. Qendrat për Punë Sociale;

4.2. Qëndrimi ditor,

4.3. Familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;

4.4. Shërbimet e strehimit rezidencial

4.5. Shtëpitë me bazë në komunitetet për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar, të rritur, dhe persona të moshuar, dhe

4.6. Shërbime tjera sociale komunale në pajtim me mundësitë buxhetore.

5. Financimi Komunal për shërbime sociale dhe familjare, rregullohet me formulën e financimit të përcaktuar nga Ministria përkatëse për Financa në grantin e veçantë për shërbime sociale dhe familjare në pajtim me Ligjin përkatës për financat e pushtetit lokal.

Neni 75

Kriteret për përcaktimin e tarifave për shërbimet sociale dhe familjare

1. Kriteret për përcaktimin e tarifave për shërbimet sociale dhe familjare të cilën e siguron institucioni publik e përcakton Ministria.

2. Kriteret për përcaktimin e tarifave të shërbimeve sociale dhe familjare, e cila financohet nga buxheti i komunës e përcakton organi kompetent i komunës.

Neni 76

Partneriteti publiko privat në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Partneriteti publiko-privat në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, mund të krijohet përmes bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike dhe sektorit privat për ndarjen e obligimeve me qëllim të sigurimit të financimit, ndërtimit, riparimit, menaxhimit, operimit për sigurimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

2. Partnerë nga sektori publik mund të jetë një apo më shumë institucione publike që lidhin kontratë me një apo më shumë partnerë privat, me qëllim të realizimit të një projekti të përbashkët në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

3. Partneriteti publiko-privat në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare zbatohet nëse sigurohet cilësi, shërbimet janë të arsyeshme në aspektin social dhe ekonomik dhe përmbushin kriteret për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

4. Procedura, kushtet dhe parimet e zbatimit të partneritetit publiko-privat në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

KAPITULLI XII

EVIDENCA

Neni 77

Evidenca

1. Secili përfitues dhe të gjitha shërbimet që ofrohen evidentohen në bazën e të dhënave dhe ruhen në kopje fizike në institucionin apo ofruesit tjerë të shërbimeve përkatëse sociale dhe familjare.
2. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për shërbimet sociale dhe familjare bëhet në pajtim me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Departamenti përkatës i Ministrisë mbanë evidencën e institucioneve dhe të ofruesve tjerë të shërbimeve.
4. Mbajtja e evidencës unike dhe të dokumentacionit të përfituesve të të drejtave, formës, masave dhe shërbimeve nga përkujdesi social dhe familjar përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

Neni 78

Baza e të dhënave

1. Për nevoja të kryerjes së veprimtarisë së shërbimeve sociale dhe familjare, për planifikim, përcjelle të gjendjes, si dhe për qëllime hulumtuese - shkencore dhe statistikore në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, Ministria krijon dhe mirëmban bazën elektronike të të dhënave.
2. Baza elektronike e të dhënave duhet të përfshijë dhe përmbajë të dhëna dhe informata, duke mos u kufizuar vetëm për:
 - 2.1. të drejtat nga shërbimet sociale dhe familjare;
 - 2.2. ofruesit e shërbimeve;
 - 2.3. përfituesit e shërbimeve;
 - 2.4. financimin e veprimtarive të shërbimeve sociale dhe familjare;
 - 2.5. rastet e tjera në pajtim me ligjin.

3. Departamenti përkatës i Ministrisë mirëmban bazën elektronike të të dhënave dhe të sistemit informativ të përgjithshëm të shërbimeve sociale dhe familjare.
4. Departamenti jep autorizime dhe cakton vëllimin e autorizimeve për qasje në bazën elektronike të të dhënave, për regjistrimin e të dhënave të reja dhe shfrytëzimin e të dhënave ekzistuese.
5. Të dhënat në sistemin e shërbimeve sociale dhe familjare ruhen në pajtim me ligjin me të cilin është rregulluar mbrojtja e të dhënave personale.
6. Kushtet e veçanta për përmbajtjen e bazës së të dhënave, ruajtjen, qasjen, evidencën dhe dokumentacionin, e përcakton organi kompetent i administratës publike.

Neni 79

Licenca

1. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë regjistrohet në regjistrin e ofruesve të licencuar të shërbimeve, të cilin e mban Departamenti përkatës i Ministrisë.
2. Licenca për punë regjistrohet në regjistrin e punëtorëve të licencuar profesional, të cilin e mban Departamenti përkatës i Ministrisë.
3. Përmbajtja e licencës rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.

Neni 80

Ofrimi i ndihmës reciproke

1. Në kuadër të zotimeve ndërkombëtare institucionet dhe ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare pranojnë dhe ofrojnë ndihmë reciproke shteteve që e kërkojnë këtë ndihmë, dhe ndërmarrin masa për të vënë kontakte në rastet kur kjo ndihmë kërkohet jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
2. Rëndësi të veçantë i duhet kushtuar bashkëpunimit ndërkufitar me qëllim të themelimit dhe forcimit të bashkëpunimit për zbatimin efikas të shërbimeve sociale dhe familjare, që janë të natyrës urgjente dhe ndër sektoriale për personat në nevojë dhe ata që janë të cenueshëm dhe pa mbrojtje.

KAPITULLI XIII

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 81

Dispozitat kundërvajtëse

1. Gjykata kompetente shqipton gjobë prej pesëqind (500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro për institucionin publik apo subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës, në rast se:

1.1. fillon punën para se organi kompetent konstaton se janë plotësuar kushtet e parapara për fillimin e punës në pajtim me këtë Ligj dhe aktet nënligjore.

1.2. nuk mban në mënyrën e paraparë evidencën dhe dokumentacionin e përfituesit, llojet e shërbimeve dhe të çështjeve tjera, apo nëse për to nuk dërgon raporte në pajtim me këtë Ligj.

1.3. vazhdon me punën pasi që e ka ç ‘regjistruar ushtrimin e punëve sipas legjislacionit në fuqi.

1.4. ofron shërbime të vendosjes për numrin më të madh të përfituesve nga kapacitetet që i ka vërtetuar organi kompetent me rastin e përcaktimit të plotësimit të kushteve të parapara për fillimin e punës në pajtim me këtë Ligj dhe aktet nënligjore.

1.5. zhvillon procedurat ashtu që nuk siguron besueshmërinë e të dhënave dhe dinjitetit të përfituesve ose të detyrave të ruajtjes së fshehtësisë profesionale në pajtim me këtë Ligj.

2. Zyrtari përgjegjës i institucionit publik, subjektit privat si dhe i autoritetit kompetent përkatës dënohet me gjobë prej treqind (300) euro deri në dymijë (2.000) euro në rastet kur është përgjegjës sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Personi fizik që ofron shërbime përkatëse, dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro, deri në pesëmijë (5.000) euro në rastet kur është përgjegjës sipas paragrafit 1 të këtij neni.

KAPITULLI XIV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 82 Aktet nënligjore

1. Aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji, do të nxirren brenda një (1) viti prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore të parapara me këtë Ligj, zbatohen aktet nënligjore në fuqi në qoftë se nuk janë në kundërshtim me këtë Ligj.

Neni 83 Vazhdimi i realizimit të të drejtave të papërfunduara

1. Procedurat për realizimin e të drejtave dhe ofrimin e shërbimeve sociale të cilat kanë filluar, ndërsa nuk kanë përfunduar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të këtij Ligji, përveç nëse dispozitat e ligjit që ka qenë në fuqi janë më të favorshme për personin i cili pranon shërbimet.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, ofruesit e shërbimeve sociale ekzistuese në Republikën e Kosovës vazhdojnë me punën e tyre, ndërsa obligohen që të përmbushin detyrimet e përcaktuara me këtë Ligj dhe me aktet e tjera nënligjore.

Neni 84
Rrjedhja e afatit

Pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, nëse periudha e parashikuar kohore është duke rrjedhur, kjo periudhë llogaritet në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, përveç nëse periudha e mëparshme ka qenë më e gjatë, apo nëse me dispozitat e këtij Ligji përcaktohet ndryshe.

Neni 85
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji Nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Neni 86
Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-255
14 dhjetor 2023

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës